Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

Tabelat e Burim - Përdorimeve dhe Input - Output në Shqipëri

2009-2011

Instituti i Statistikave

Tabelat e Burimeve, Përdorimeve dhe Input-Output

në Shqipëri: 2009-2011

Shkurt 2015

Tabelat e Burimeve, Përdorimeve dhe Input-Output në Shqipëri: 2009-2011
Shkurt , 2015

Drejtor botimi
Dr. Gjergji FILIPI

INSTAT
Gjergji Mano
Ledjon Shahini
Elona Muskaj
Ermir Liço
Lindita Becolli

Copyright © INSTAT 2015

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

Përpunimi në kompjuter
Anila Koçi

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Blv. "Zhan D'Ark", Nr.3, Tiranë / Albania
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: + 355 4 228300
E-mail : info@instat.gov.al

Përmbajtje:

1. Parathënie 6
2. Tabelat e Burimeve dhe Përdorimeve 7
2.1. Tabelat e Burimeve 9
2.2. Tabelat e Përdorimeve 10
3. Sistemi i Nomenklaturave 12
4. Zhvillimet e tabelave të burimeve dhe përdorimeve në Shqipëri 13
5. Rezultatet e arritura 14
6. Material Metodologjik 29
6.1. Tabelat e Burimeve dhe Përdorimeve me çmime korente 29
6.1.1. Prodhimi 29
6.1.2. Importi 33
6.1.3. Marzhi Tregtar 34
6.1.4. Marzhi i Transportit 38
6.1.5. Taksat dhe subvencionet mbi produktet 39
6.1.6. Konsumi i ndërmjetëm 40
6.1.7. Konsumi i Familjeve 41
6.1.8. Eksporti 43
6.1.9. Formimi i Kapitalit Fiks Bruto 43
6.1.10. Shpenzimet e konsumit final të qeverisë dhe OJF-ve 45
6.1.11. Ndryshimi në inventarë 45
6.2. Procesi balancues 48
6.3. Tabelat e Burimeve dhe Përdorimeve me çmime konstante 49
7. Tabelat input-output 53
7.1. Baza e të dhënave për transformimin 54
7.2. Llogaritja e tabelave simetrike input-output 56
Anekse: 58
Bibliografia 65

Lista e Tabelave:

Tabela 1: Tabela e burimeve dhe përdorimeve 8
Tabela 2: Tabela e burimeve 10
Tabela 3: Tabela e përdorimeve 11
Tabela 4: Vlerësimi i PBB-së me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve nga TBP-të (milion lekë) 15
Tabela 5: Tabela e burimeve dhe përdorimeve me çmime korente për vitin 2011 (milion lekë) 18
Tabela 6: Tabela e burimeve me çmime korente për vitin 2011 (milion lekë) 19
Tabela 7: Burimet e produkteve me çmime bazë sipas origjinës 20
Tabela 8: Struktura e tabelës së burimeve për vitin 2011 sipas produkteve (%) 22
Tabela 9: Struktura e tabelës së burimeve për vitin 2011 sipas aktiviteteve (%) 22
Tabela 10: Tabela e përdorimeve me çmime korente për vitin 2011 (milion lekë) 24
Tabela 11: Struktura e tabelës së përdorimeve për vitin 2011 sipas produkteve (%) 26
Tabela 12: Struktura e tabelës së përdorimeve për vitin 2011 sipas aktiviteteve (%) 27
Tabela 13: Tabela Input-Output për vitin 2011 (milion lekë) 28
Tabela 14: Ndarja e shifrës së afarizmit 30
Tabela 15: Lista e produkteve industriale 30
Tabela 16: Burimet e përdorura për shpërndarjen e prodhimit sipas aktiviteteve 32
Tabela 17: Niveli i detajimit të importit të shërbimeve 33
Tabela 18: Kanalet shpërndarës të produkteve 37
Tabela 19: Përcaktimi i marzhit të tregtisë për çdo kanal qarkullues 37
Tabela 20: Marzhet e tregtisë dhe transportit - burimet 38
Tabela 21: Burimet e përdorura për shpërndarjen e konsumit të ndërmjetëm 40
Tabela 22: Klasifikimi i FKFB 43
Tabela 23: Kategoritë e të mirave të importuara sipas nomenklaturës BEC 44
Tabela 24: Klasifikimi i ndryshimit të gjendjeve 46
Tabela 25: Inventari 46
Tabela 26: Tabela Input-Output me çmime bazë (produkt-për-produkt) 55

Lista e Grafikëve:

Grafiku 1: Struktura e PBB-së sipas metodës së prodhimit 16
Grafiku 2: Struktura e PBB-së sipas metodës së shpenzimeve 17
Grafiku 3: Produktet homogjene dhe aktivitetet ekonomike të prodhimit 21
Grafiku 4: Burimet sipas kategorive 23
Grafiku 5: Produktet homogjene dhe aktivitetet ekonomike të konsumit ndërmjetës 24
Grafiku 6: Përdorimet sipas kategorive 25

Lista e Figurave

Figura 1: Lidhja e nomenklaturave 12

1. Parathënie

Sistemi i Llogarive Kombëtare përmban një gamë të gjerë treguesish makroekonomik të cilët duhet që të jenë të integruar në kohë dhe vlerë. Një nga treguesit më kryesor është Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) i cili mund të vlerësohet me tri metoda të ndryshme duke u nisur nga krahu i prodhimit, shpenzimeve ose të ardhurave. Secila metodë bazohet në një pikëpamje të ndryshme të sistemit ekonomik duke përdorur dhe vlerësuar agregatë të ndryshëm të saj e duke na ofruar në këtë mënyrë një përmbledhje të marrëdhënieve logjike brenda sistemit kombëtar. Në përgjithësi nuk mund të thuhet se cila nga metodat është më e besueshmja, kjo varet nga cilësia e burimeve që janë përdorur në secilën metodë. Është synimi i procesit të balancimit të përcaktojë burimet dhe metodat më të besueshme dhe në fund se cili është vlerësimi më i mirë i PBB-së.

Procesi balancues është një pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e metodologjisë së përdorur. Ky proces tenton përdorimin optimal të informacionit ekzistues për nxjerrjen e një vlerësimi sa më të saktë. Në terma të tjerë, balancimi kërkon që të gjitha të dhënat statistikore, si nga krahu i prodhimit, shpenzimeve apo të ardhurave të përshtaten dhe të jenë të barabarta ndërmjet tyre. Ky barazim shpesh është i njohur si sistemi i tabelave të burimeve dhe përdorimeve (TBP), ku për çdo produkt jepet informacion për përdorimin e tij. Produkti final i procesit të balancimit duhet të jetë një grup llogarish tërësisht i balancuar dhe i artikuluar me një vlerësim të vetëm të PBB-së.

Sistemi i TBP-ve përbëhet nga dy tabela kryesore, ajo e burimeve dhe ajo e përdorimeve. Tabela e parë mundëson që për çdo produkt të kemi burimet e furnizimit të cilat mund të jenë prodhuar brenda vendit ose mund të jenë importuar. Për të kaluar vlerën e produktit me çmimet e tregut secilit produkt duhet ti shtojmë taksat neto dhe marzhet e tregtisë dhe transportit. Në këtë nivel vlera për secilin produkt duhet të shfaqet nga krahu i përdorimeve. Tabela e përdorimeve përmban destinacionin e çdo produkti në ekonomi, pra nëse shkon për konsum ndërmjetës në një ndërmarrje prodhuese, konsum final për familjet ose qeverinë, në trajtën e investimit, eksport ose ngelet si ndryshim inventari.

Nëse këto tabela janë të balancuara, kjo do të thotë se mallrat dhe shërbimet e prodhuara kanë një destinacion përfundimtar përdorimi dhe si rrjedhim ekonomia në tërësi do të jetë gjithashtu e balancuar. Tabela e burimeve dhe përdorimeve është veçanërisht e përshtatshme për të plotësuar boshllëqet që ekzistojnë në të dhëna. Ky kuadër lejon një kombinim të informacioneve më të detajuara me ato më të agreguara, për shembull, shitjet me pakicë mund të jenë në dispozicion vetëm në nivel aktiviteti, por përdorimi i të dhënave të tregtisë së jashtme, të cilat janë në nivele produkti mund të mundësojnë prodhimin e të dhënave të hollësishme mbi konsumin familjar. Këto të dhëna të hollësishme mund të jenë të dobishme për disa përdorues të cilët duan të bëjnë analiza në nivel produkti të ekonomisë dhe gjithashtu mund të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së indekseve të përdorura.

Balancimi duhet të bëhet për seritë me çmime korente dhe konstante, në mënyrë që të sigurojë një grup të integruar dhe të qëndrueshëm të llogarive, duke mundësuar kështu përdorimin optimal të të dhënave të çmimeve. Ndërtimi i TBP-ve me çmime konstante mundëson vlerësimin e një vlere të vetme të treguesit të rritjes ekonomike pavarësisht metodës së përdorur duke specifikuar edhe rritjen homogjene të çdo komponenti. Një avantazh tjetër që ka përdorimi i TBP-ve lidhet me faktin se ky sistem mundëson një rritje të konsiderueshme të vlerësimeve në terma volumi. Kjo për faktin se trajtimi i produkteve bëhet në nivel shumë më të detajuar se vlerësimet direkt të PBB-së duke zbërthyer edhe komponentët përbërës të saj. Zbërthimi në produkte homogjene i të gjitha të mirave dhe shërbimeve që prodhohen apo konsumohen në vend mundëson aplikimin korrekt të indeksit të çmimit.

2. Tabelat e Burimeve dhe Përdorimeve

Tabelat e burimeve dhe përdorimeve ofrojnë portretin më të detajuar të një ekonomie. Ato ofrojnë një analizë të detajuar të procesit të prodhimit dhe përdorimit të mallrave dhe shërbimeve dhe të gjenerimit të të ardhurave të krijuara. TBP-të ofrojnë një kuadër të qëndrueshëm për balancimin e llogarive kombëtare. Këto tabela janë mjaft komplekse dhe hartimi i tyre është një sfidë e madhe për çdo vend.

Studimet e para përsa i përket analizës së ekonomisë në nivel të detajuar të qarkullimit të produkteve janë zhvilluar që në fundin e viteve 1930-të, ku më konkretisht më 1936 Profesor Wassily Leontief vlerësoi tabelat e para Input-Output (TIO) për SHBA-të për periudhën kohore 1919-1929. TIO janë një rrjedhim i TBP-ve dhe kërkojnë si kusht që këto të fundit të jenë të balancuara. Në vazhdim, në vitin 1968 Kombet e Bashkuara publikuan "Sistemin e Llogarive Kombëtare, Studime dhe Metoda" ku u trajtua integrimi i këtyre tabelave në sistemin e llogarive kombëtare duke përmirësuar në masë të madhe analizat empirike mbi ekonominë. Koncepti i TBP-ve u trajtua si pjesë më vete në Sistemin Evropian të Llogarive, 1995 (Eurostat, 1995), ndërsa hapat e para për një manual specifik lidhur me ndërtimin e këtyre tabelave Eurostat e filloi në vitin 2002 për të konkluduar në vitin 2008 me një manual të plotë të përpilimit të tabelave të burimeve dhe përdorimeve (Eurostat, 2008). Trajtimin teorik më të fundit lidhur me këto tabela e gjejmë në Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare, 2010 (Eurostat, 2010).

Për ndërtimin e TBP-ve kërkohet që të mblidhen, verifikohen dhe analizohen një grup i madh treguesish të cilët mundësojnë sintezën e plotë të sistemit të llogarive kombëtare. Këto tabela japin portretin më të detajuar të ekonomisë, pasi paraqesin hap pas hapi një analizë të detajuar të procesit të prodhimit dhe përdorimit të mallrave dhe shërbimeve dhe të ardhurave të krijuara. Ndërtimi i tyre në nivele më të detajuar dhe me një cilësi më të saktë kërkon një informacion të detajuar në nivele produktesh. Cilësia e informacionit të mbledhur ndikon direkt në cilësinë e balancimit të qarkullimit të çdo produkti në ekonomi. Balancimi i TBP-ve është i domosdoshëm të bëhet si me çmime korente ashtu edhe me çmime konstante. Avantazhi i këtyre tabelave është mundësia që japin për të vlerësuar me çmime konstante secilin përbërës të PBB-së me metodën e prodhimit, që është e njohur si metoda e deflatimit të dyfishtë.

Në tabelën 1 është paraqitur një sistem i TBP-ve ku mund të shihen qartë komponentët përbërës të saj. Në krahun e majtë të tyre kemi totalin e burimeve të një vendi të shprehur në nivel produkti ndërsa në krahun e djathtë të tabelës janë përdorimet e çdo produkti.

Tabela 1: Tabela e burimeve dhe përdorimeve

Aktiviteti (NVE) / Produktet (CPA)	Prodhimi sipas aktiviteteve (NVE)							Importet CIF	Axhustimet	Totali	Inputet sipas aktiviteteve (NVE)							Totali i përdorimeve	Totali
	1	2	…	…	m-1	m	Totali				1	2	…	…	m-1	m	Totali		
1 2 … … … … n-1 n	Matrica e Prodhimit						Prodhimi i brendshëm sipas produkteve	Matri ca e importeve	Matrica e axhustimeve	Totali i burimeve me çmimet e blerjes	Matrica e Konsumit Ndërmjetës me çmime tregu						Totali I IC sipas produkteve	Kërkesa Finale me çmime blerje	Totali i Përdorim me çmimet e blerjes
Totali	Totali i prodhimit të aktiviteteve në çmime bazë										Totali i konsumit ndërmjetëm sipas aktiviteteve								
											Vlera e Shtuar Bruto								
											Komponentët e të ardhurave								

Pjesa e fundit e tabelës përmban komponentët e PBB-së me metodën e të ardhurave, pra alokimin e tyre në ekonomi sipas kategorive kryesore dhe aktivitetit ekonomik. Balancimi i TBP-ve kërkon si kusht që një vend të jetë në gjendje të prodhojë komponentët e PBB-së me metodën e prodhimit dhe të shpenzimeve pasi janë kryesorët në këtë proces. Pjesa e alokimit të të ardhurave në ekonomi përfshihet në sistem për të pasqyruar ciklin e plotë të ekonomisë.

2.1. Tabelat e Burimeve

Tabela e burimeve tregon grupet e të mirave dhe shërbimeve sipas produktit në një ekonomi, për një periudhë të caktuar kohore. Ajo përbëhet nga matrica e prodhimit e cila në vetvete ndahet në dy pjesë kryesore; nga prodhimi i brendshëm dhe nga importet, matrica e marzheve të transportit dhe tregtisë, si dhe matrica e taksave neto (taksa minus subvencione mbi produktet). Ky sistem i plotë matricor mundëson transformim e burimeve nga çmime bazë në çmime tregu.

Transformimi përveç rëndësisë ekonomike është edhe një kërkesë e ESA 1995 dhe 2010 e cila kërkon që tabela e burimeve me çmime bazë të transformohet në çmime blerësi. Tabela e burimeve përmban tre matrica të rëndësishme:

- matrica e prodhimit,
- matrica e importeve,
- matrica e axhustimeve,

Matricat kanë një strukturë në rreshta sipas kategorisë së produkteve, duke lejuar agregimin horizontal të të gjithë elementëve nga prodhimi total i industrive me çmime bazë, deri te burimet totale me çmimet e blerësit. Në hapin e parë prodhimi i brendshëm me çmime bazë dhe importet në CIF[1] agregohen në burimet totale në çmime bazë. Në hapin e dytë vektorët e vlerësimit të marzhit të tregtisë dhe transportit, si dhe taksat neto mbi produktin i shtohen totalit të burimeve me çmime bazë për të përfituar totalin e burimeve me çmimet e blerësit. Prodhimi i përgjithshëm i një industrie në çmime bazë korrespondon me prodhimin total të një industrie në tabelën e furnizimit ose burimit.

Në tabelën 2 jepet një pasqyrim i tabelës së burimeve në nivel të agreguar produktesh dhe aktivitetesh. Në realitet niveli i detajimit është shumë më i madh në mënyrë që të jap një pamje sa më të plotë të një produkti homogjen.

[1] CIF (Cost of Insurance and Freight-ang) tregon vlerën e mallrave të importuara apo eksportuara duke përfshirë kostot deri në pikën e fundit kufitare të vendit origjinë.

Tabela 2: Tabela e burimeve

Aktiviteti (NVE) / Produktet (CPA)	Prodhimi sipas aktivitete ve (NVE)							Importet		Axhustimet		
	1	2	…..	…..	m-1	m	Totali	Importet CIF	Totali i ofertës me çmime bazë	Marzhet e tregtisë dhe transportit	Taksat minus subvencionet mbi produktet	Totali i ofertës me çmimet e blerjes
1 2 … … … … n-1 n	Matrica e Prodhimit						Prodhimi i brendshëm sipas produkteve	Matrica e importeve	Totali i ofertës me çmime bazë	Matrica e axhustimeve		Totali i ofertës me çmimet e blerjes për çdo produkt
Totali	Totali i prodhimit të aktiviteteve në çmime bazë											
Axhustimet CIF/FOB të importeve												
Blerjet direkt të rezidentëve jashtë												
Totali	Totali i prodhimit të aktiviteteve në çmime bazë							Importe FOB		Totali		
Prodhimi për Treg												
Prodhim për përdorim vetjak												
Prodhim jo i tregut												

Në tabelën e burimeve, nëse është e mundur prodhimi total i çdo aktiviteti ekonomik duhet që të ndahet në prodhim për treg, për përdorim vetjak ose për jo treg. Kjo ndarje lidhet kryesisht edhe me sektorët ekonomik të cilët kanë shpesh edhe qëllime të ndryshme prodhimi.

2.2. Tabelat e Përdorimeve

Një tabelë përdorimi tregon përdorimin e mallrave dhe shërbimeve sipas produktit dhe llojit të përdorimit për konsum të ndërmjetëm (sipas industrisë), konsum final, formim kapitali fiks bruto ose eksport. Pjesa e fundit e kësaj tabele gjithashtu tregon komponentët e vlerës së shtuar bruto me metodën e të ardhurave të cilët janë kompensimi i punonjësve, surplusi operativ, taksat të tjera neto mbi prodhimin dhe konsumi i kapitalit fiks. Tabela e përdorimit ka dy objektiva kryesore, së pari, ajo paraqet në kolona strukturën e kontributit për çdo industri dhe së dyti përshkruan në rreshta përdorimin e produkteve të ndryshme dhe inputeve primarë (punës dhe kapitalit) të përdorur. Tabela e përdorimeve është e vlerësuar me çmime tregu, ndryshe nga prodhimi i cili është me çmime bazë. Për këtë qëllim shpesh është e rëndësishme që kjo tabelë të konvertohet edhe me çmime bazë. Për të mundësuar këtë vlerësim duhet që të zbresim marzhet e tregtisë dhe transportit si dhe taksat neto nga tabela e përdorimeve.

Në tabelën 3 është paraqitur tabela e përdorimeve me të gjithë komponentët e saj ku mund të vihet re që matrica e konsumit ndërmjetës është e barabartë me matricën e prodhimit ndërsa komponentët e kërkesës finale janë matrica vektoriale me të njëjtin numër produktesh si edhe matricat e tjera.

Tabela 3: Tabela e përdorimeve


Aktiviteti (NVE) / Produktet (CPA)	Inputet sipas aktiviteteve (NVE)							Totali i përdorimeve						Totali i Përdorimeve me çmimet e blerjes
	1	2	…	…	m-1	m	Totali	Eksportet	Konsumi i Familjeve	Konsumi i Qeverisë	Konsumi i organizatave Jo-Fitimprurëse	Formimi i Kapitali Fiks Bruto	Ndryshim Gjendje	
1	Matrica e Konsumit Ndërmjetës me çmime tregu						Totali I konsumit ndërmjetëm sipas produkteve	Kërkesa Finale me çmime blerje						
2														
…														
…														
…														
…														
n-1														
n														
Totali	Totali i konsumit ndërmjetëm sipas aktiviteteve													
Axhustimet CIF/FOB								Axhustimet						
Blerjet direkt të rezidentëve jashtë														
Blerjet direkt të jo - rezidentëve në tregun vendas														
Totali														
Kompensimi i punonjësve	Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë													
Taksat neto mbi prodhimin														
Amortizimi i kapitali fiks														
Surplusi operativ neto														
Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë														
Prodhimi me çmime bazë														

Në këtë tabelë në pjesën e kërkesës finale mund të paraqitet edhe informacion shtesë mbi blerjet e rezidentëve jashtë vendit dhe të jo-rezidentëve brenda vendit duke pasqyruar në këtë mënyrë edhe një marrëdhënie të ekonomisë me sektorin e pjesës tjetër të botës.

3. Sistemi i Nomenklaturave

Përpara se të flasim mbi vlerësimin e TBP-ve në Shqipëri është shumë e rëndësishme që të japim një pamje të përgjithshme të nomenklaturave që përdoren në këtë sistem dhe ndërlidhjet që kanë ato me njëra tjetrën. Në figurën 1 jepet një paraqitje skematike e nomenklaturave që përdoren në rang ndërkombëtar për të kaluar në nivelin evropian e më pas në nomenklaturat që përdor secili vend të cilat janë në sinkronizim me ato ndërkombëtare. Shpesh këto nomenklatura për shkak të detajimit që përmbajnë si dhe qëllimit parësor që kanë mund të mos kenë një lidhje të drejtpërdrejt ndërmjet tyre gjithsesi studime në nivele të detajuara janë zhvilluar për të mundësuar kombinimin sa më të mirë të tyre.

Figura 1: Lidhja e nomenklaturave



Përsa i përket nomenklaturave ndërkombëtare ISIC përfaqëson grupin e aktiviteteve ekonomike ndërsa CPC produktet e të mirave dhe shërbimeve. Nomenklatura HS është niveli më i detajuar i nomenklaturave ndërkombëtare e cila është nomenklatura referencë për CPC dhe SITC. Në nivel evropian niveli më i agreguar është NACE e cila është e derivuar nga ISIC dhe ka të njëjta kategori në nivelin e agreguar por në nivel të detajuar është më e hollësishme sesa ky i pari. Në të njëjtën kohë NACE shërben për të derivuar edhe CPA -në e cila është nomenklatura e produkteve për të mirat dhe shërbimet në nivel evropian.

Në rastin e nomenklaturave evropiane ndërmjet CPA-së dhe CN -së e cila është derivim i HS-së, ekziston një lidhje e plotë. Në nivel evropian kemi edhe një nomenklaturë të detajuar vetëm për të mirat e njohur si PRODCOM i cili ka një detajim 8-shifror nga 6 që ka CPA.

Çdo vend në mënyrë paralele me sistemin ndërkombëtar apo atë evropian zhvillon edhe nomenklaturat e veta kombëtare të cilat janë në koherencë me të mësipërmet por duke ruajtur produktet dhe aktivitetet të cilat janë më të rëndësishme për vendin. Siç mund të shohim edhe nomenklaturat kombëtare janë derivime të atyre të mësipërme që në rastin e Shqipërisë janë derivim i nomenklaturave evropiane.

4. Zhvillimet e tabelave të burimeve dhe përdorimeve në Shqipëri

Edhe pse TBP-të kanë relativisht një kohë të gjatë që janë ndërtuar, si sistem ndërtimi i tyre nuk është bërë akoma nga shumë vende në zhvillim. Përsa i përket Shqipërisë aplikimi i TBP-ve është një risi në sistemin e llogarive kombëtare. Ky publikim është i pari i këtij lloji edhe pse disa përpjekje janë bërë që në vitin 2005 por mungesa e informacionit nuk mundësonte një vlerësim të tyre për Shqipërinë. Gjatë projektit IPA 2007 analizat për të ndërtuar këtë sistem filluan përsëri duke konkluduar me ndërtimin e tyre në nivel eksperimental për vitet 2008 dhe 2009.

Në vitet në vazhdim punimet u fokusuan së tepërmi në analiza të shumta të burimeve dhe shtim të informacionit për të përmirësuar vlerësimin e këtyre tabelave dhe arritjen e një niveli të kënaqshëm cilësor për publikim.
Kështu në Anketën Strukturore pranë Ndërmarrjeve (ASN) në vitin 2010 u mblodh informacion mbi strukturat e kostove të ndërmarrjes në një nivel agregimi CPA 2-shifrore. Ky informacion është marrë për tre vite të njëpasnjëshëm në mënyrë që të mundësojë një rritje të cilësisë së këtij treguesi i cili mbetet pika më e dobët e informacionit të përdorur në këto tabela pasi mblidhet në një nivel shumë të agreguar.

Në ASN 2012 u bë edhe një detajim në CPA 2 dhe 3 shifrore si dhe një detajim më i mirë i shpenzimeve operative të përdorura nga ndërmarrjet. Gjithsesi informacioni i strukturës së kostos vazhdon të jetë shumë i agreguar për të mundësuar një analizë të detajuar në nivel produkti. Për të konsoliduar informacionet e marra nga ndërmarrjet analiza të shumta bëhen me të dhënat nga tregtia e jashtme ku kemi informacion sipas produkteve dhe ndërmarrjeve për importet dhe eksportet. Analizat mbështeten gjithashtu edhe mbi të dhëna të tjera administrative si ato të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, apo agjencive të ndryshme në Shqipëri.

Punimet për vlerësimin e këtyre tabelave në Shqipëri janë bërë në një nivel shumë të detajuar që për disa komponent shkon edhe mbi 1000 produkte ndërsa analizat balancuese janë bërë në nivel NVE 2 shifrore. Analizat në nivel produkti janë bërë mbi një metodë të njohur si qarkullimi i produktit (MQP) për të cilin përcaktohen të gjithë komponentët në nivel të detajuar të burimit të tij dhe përdorimeve të mundshme përkatëse. Dallimi midis TBP-ve dhe MPQ-ve është se kjo e fundit nuk e trajton konsumin ndërmjetës dhe prodhimin sipas aktiviteteve por vetëm në nivel produkti duke mundësuar në këtë mënyrë një trajtë më të detajuar trajtimi.

Vlerësimet e TBP-ve në Shqipëri përveç nivelit të vlerësimit 60 produkte *60 aktivitete (NVE 2 shifrore) janë bërë edhe në nivele të tjera agregimi si 25*25 dhe 13*13. Këto nivele janë zhvilluar për të mundësuar publikimin e këtyre tabelave në koherencë me publikimet e tjera të llogarive kombëtare në Shqipëri. Të gjitha klasifikimet dhe nomenklaturat e përdorura janë në koherencë me ato të Eurostat duke mundësuar një pamje të krahasueshme të këtyre tabelave në arenën ndërkombëtare.

Një moment shumë i rëndësishëm për tu përmendur në vlerësimet që po bëhen në Shqipëri në kuadër të këtij sistemi është edhe vlerësimi i tyre me çmime konstante. Avantazhi i realizimit të këtij procesi është që mundëson një lidhje shumë të detajuar të produktit me çmimin përkatës që ka. Duke ju referuar përsëri nivelit të detajimit të produkteve të trajtuara, përcaktimi i indekseve respektive të çmimit është shumë më koherent sesa ai i përdorur në industrinë përkatëse.
Sistemi i TBP-ve përbëhet edhe nga tabela matricore të tjera mbështetëse të cilat rrisin ndjeshëm cilësinë e vlerësimit të tyre. Ndër këto tabela matricore mund të përmendim:

- matricën e konsumit ndërmjetës nga importet,
- matricën e taksave,
- matricën e marzhit të transporti dhe të tregtisë,
- matricat vektoriale të importeve për komponentët e kërkesës finale,

Ndërtimi i këtyre tabelave shtesë mundëson analizë më të plotë të qarkullimit të produktit nga njëra anë dhe nga ana tjetër përcakton më mirë komponentët përbërës të një agregati. Këto matrica janë të rëndësishme edhe për të vlerësuar tabelën e përdorimeve me çmime bazë e cila është një transformim i asaj me çmime tregu.

5. Rezultatet e arritura

Në këtë botim të parë të TBP-ve për Shqipërinë u bë e mundur ndërtimi dhe balancimi i tyre për vitet 2009 -2011 me çmime korente. Në këto vlerësime janë përfshirë vetëm metoda e prodhimit dhe e shpenzimeve të PBB-së pasi vlerësimi i saj me metodën e të ardhurave është akoma i pa mundur për vendin tonë. Avantazhi i TBP-ve është se mundësojnë një vlerë të vetme të PBB-së pavarësisht metodës së përdorur si dhe japin një pamje të qartë të aktiviteteve dytësore dhe inputeve të përdorura në çdo aktivitet të ekonomisë.


Në tabelën 4 është bërë një paraqitje e agreguar e këtyre rezultateve për Shqipërinë ku mund të shihet barazimi i të dy metodave të vlerësimit të PBB-së për vitet 2009-2011. Rezultatet nga krahu i prodhimit janë paraqitur të ndara edhe në komponentët e prodhimit dhe konsumit ndërmjetës për disa nga aktivitetet kryesore të ekonomisë. PBB me metodën e shpenzimit është pasqyruar në komponentët kryesor të saj në pjesën e dytë të tabelës.

Tabela 4: Vlerësimi i PBB-së me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve nga TBP-të (milionë lekë)

Përshkrimi	2011			2010			2009		
	Prodhimi	Konsumi Ndërmjetës	Vlera e Shtuar	Prodhimi	Konsumi Ndërmjetës	Vlera e Shtuar	Prodhimi	Konsumi Ndërmjetës	Vlera e Shtuar
Bujqësia, peshkimi gjuetia dhe silvikultura	333.019	95.958	237.062	312.470	89.882	222.589	274.993	82.875	192.117
Industria	422.737	261.497	161.240	375.415	221.049	154.367	301.490	187.120	114.371
Ndërtimi	473.733	310.729	163.004	441.000	283.662	157.339	556.818	387.367	169.451
Tregtia, hotele dhe restorante	266.655	101.553	165.102	259.741	100.380	159.361	244.600	93.040	151.561
Transporti, posta dhe komunikacion	209.905	130.637	79.268	178.319	104.669	73.649	175.947	98.819	77.129
Shërbime të tjera	484.078	158.633	325.444	472.155	161.974	310.181	431.548	146.289	285.259
Taksat neto mbi produktet			169.503			161.702			154.141
PBB me metodën e prodhimit			1.300.624			1.239.187			1.144.029
Importet			738.093			657.316			614.965
Eksportet			442.390			402.141			333.404
Konsumi Final i Familjeve			1.021.965			960.232			881.859
Konsumi Final i Qeverisë			144.869			140.387			128.998
Formimi i Kapitalit Fiks Bruto			390.592			360.288			388.550
Ndryshimi i Gjendjeve			38.902			33.456			26.183
PBB me metodën e shpenzimeve			1.300.624			1.239.187			1.144.029


Në grafikun 1 është bërë një paraqitje e peshës së sektorëve kryesor të ekonomisë ndaj totalit të PBB-së për vitin 2011. Nga grafiku shohim që pjesën më të madhe e përbëjnë shërbimet e tjera me 25 % ndjekur nga sektori i bujqësisë me 18,2 %. Sektori me peshën më të vogël është transporti, posta dhe komunikacioni me 6,1 %.

Grafiku 1: Struktura e PBB-së sipas metodës së prodhimit



Grafiku 2 jep një paraqitje të strukturës së PBB-së me metodën e shpenzimeve sipas komponentëve kryesor të saj, ku vihet re që konsumi i familjeve përbën pjesën më të madhe të PBB-së me 78,6 % ndërsa ndryshimi i gjendjeve është komponenti më peshën më të ulët me vetëm 3 %.

Grafiku 2: Struktura e PBB-së sipas metodës së shpenzimeve



Në tabelën 5 është bërë një paraqitje e agreguar e TBP-ve në tre grupe kryesore (bujqësi, industri dhe shërbime) për vitin 2011 si viti më i fundit i vlerësimeve. Në pjesën e majtë të tabelës kemi burimet e vendit të cilët më pas shkojnë si përdorime në krahun e djathtë. Në rreshtin e fundit të matricës së konsumit ndërmjetës paraqitet edhe vlera e shtuar sipas aktiviteteve e cila shohim se është një e vetme pavarësisht se cilës metode vlerësimi të PBB-së i referohemi.

Tabela 5: Tabela e burimeve dhe përdorimeve me çmime korente për vitin 2011 (milionë lekë)

Aktivitete (NVE) / Produkte (CPA)	Bujqësia	Industria	Shërbime	Prodhimi sipas produkteve	MTT*	Totali i Burimeve	Bujqësia	Industria	Shërbime	Konsumit ndërmjetës sipas produkteve	KF**	Totali i Përdorimeve
Bujqësia	242.902	0	0	242.902	84.081	326.982	68.954	24.954	13.403	107.310	219.672	326.982
Industria	89.891	824.400	6.491	920.782	861.757	1.782.539	20.658	485.047	200.532	706.237	1.076.302	1.782.539
Shërbime	227	72.070	954.147	1.026.444	- 38.241	988.203	6.346	62.225	176.889	245.460	742.743	988.203
Totali	333.019	896.470	960.638	2.190.127	907.597	3.097.724	95.958	572.226	390.823	1.059.007	2.038.718	3.097.724
Vlera e Shtuar							237.062	324.244	569.815	1.131.121		

* Marzhet e transportit, tregtisë dhe taksat neto mbi produktet
** Komponentët e kërkesës finale

Për të bërë një analizë disi më të plotë të rezultateve në tabelën 6 është paraqitur tabela e burimeve në një nivel disagregimi prej 6 aktivitetesh dhe produktesh. Në këtë tabelë vëmë re se sektori i bujqësisë ka aktivitet dytësor industrinë. Nëse do ti referoheshim niveleve më të disagreguara të këtyre tabelave ky prodhim dytësor në sektorin e bujqësisë vjen nga industria ushqimore pasi në shumë raste kemi shkrirje të prodhimtarisë bujqësore me agro-industrinë. Nga tabela mund të vëmë re gjithashtu se sektori i ndërtimit është ai që ka më shumë aktivitete të tjera, ndërsa si degë më homogjene paraqiten shërbimet e tjera të cilat në përgjithësi përbëhen nga aktivitetet financiare, administrata publike, etj.

Tabela 6: Tabela e burimeve me çmime korente për vitin 2011 (milionë lekë)

Aktivitete (NVE) / Produkte (CPA)	Bujqësia peshkimi gjuetia dhe silvikultura	Industria	Ndërtimi	Tregtia, hotele dhe restorante	Transporti posta dhe komunikacioni	Shërbime të tjera	Totali i prodhimit sipas Produkteve	Importet (CIF)	Taksat neto mbi Produktet	Marzhi i Tregtisë dhe Transportit	Totali i Burimeve
Bujqësia, peshkimi, gjuetia dhe silvikultura	242.902	0	0	0	0	0	242.902	24.434	7.005	52.641	326.982
Industria	89.891	401.230	73.138	800	2.300	12	567.372	486.407	148.375	221.619	1.423.773
Ndërtimi	0	2.498	347.534	1.111	98	2.170	353.411	389	4.967	0	358.766
Tregtia, hotele dhe restorante	227	13.119	6.849	260.313	2.257	1.962	284.727	55.452	543	-220.511	120.211
Transporti, posta dhe komunikacion	0	5.015	7.801	4.113	201.740	245	218.915	89.377	1.619	-54.466	255.445
Shërbime të tjera	0	875	38.411	318	3.510	479.688	522.802	82.035	6.994	716	612.547
Totali i prodhimit sipas aktiviteteve	333.019	422.737	473.733	266.655	209.905	484.078	2.190.127	738.093	169.503	0	3.097.724


Në tabelën 7 paraqiten burimet me çmime bazë për vitet 2009-2011 sipas origjinës së tyre nëse janë të importuar apo të prodhuar në vend, po ashtu strukturën e prodhimit dhe importit për vitet 2009-2011 për të bërë një krahasim të ndryshimeve strukturore të ekonomisë. Një nga efektet më të qartë është rënia e peshës së aktivitetit të ndërtimit pas vitit 2009.

Tabela 7: Burimet e produkteve me çmime bazë sipas origjinës

		Prodhim vendas		Importe	
PRODUKTE (CPA)	Viti	mln lekë	%	mln lekë	%
Bujqësia, peshkimi gjuetia dhe silvikultura	2009	201.734	10	19.423	3
	2010	226.535	11	22.539	3
	2011	242.902	11	24.434	3
Industria	2009	425.630	21	383.890	62
	2010	501.435	25	424.919	65
	2011	567.372	26	486.407	66
Ndërtimi	2009	439.319	22	1.793	0
	2010	331.096	16	878	0
	2011	353.411	16	389	0
Tregtia. hotele dhe restorante	2009	252.713	13	50.600	8
	2010	276.025	14	52.902	8
	2011	284.727	13	55.452	8
Transporti, posta dhe komunikacioni	2009	193.609	10	81.158	13
	2010	196.522	10	79.171	12
	2011	218.915	10	89.377	12
Shërbime të tjera	2009	472.390	24	78.102	13
	2010	507.488	25	76.907	12
	2011	522.802	24	82.035	11
Totali i burimeve	2009	1.985.396	100	614.965	100
	2010	2.039.101	100	657.316	100
	2011	2.190.127	100	738.09	100

Në grafikun 3 është bërë një paraqitje e produkteve të pastra homogjene dhe aktiviteteve ekonomike. Nga grafiku vihet re një luhatje më e madhe e këtij krahasimi në degën e industrisë dhe ndërtimit duke na lënë të kuptojmë se këta sektorë janë më heterogjen në procesin e prodhimit.

Grafiku 3: Produktet homogjene dhe aktivitetet ekonomike të prodhimit



Kujdes duhet të bëjmë kur analizojmë strukturat e këtyre tabelave pasi struktura sipas aktivitetit mund të jetë shumë e ndryshme nga ajo sipas produkteve dhe kërkon që të ketë një interpretim të saktë të tyre. Në tabelën 7 jepet struktura sipas produkteve ndërsa në tabelën 8 sipas aktiviteteve.

Tabela 8: Struktura e tabelës së burimeve për vitin 2011 sipas produkteve (%)


Aktivitete (NVE) Produkte (CPA)	Bujqësia, peshkimi gjuetia dhe silvikultura	Industria	Ndërtimi	Tregtia, hotele dhe restorante	Transporti, posta dhe komunikacioni	Shërbime të tjera	Totali i prodhimit sipas produkteve
Bujqësia, peshkimi, gjuetia dhe silvikultura	100	0	0	0	0	0	100
Industria	15,8	70,7	12,9	0,1	0,4	0	100
Ndërtimi	0,0	0,7	98,3	0,3	0,0	0,6	100
Tregtia, hotele dhe restorante	0,1	4,6	2,4	91,4	0,8	0,7	100
Transporti, posta dhe komunikacioni	0	2,3	3,6	1,9	92,2	0,1	100
Shërbime të tjera	0	0,2	7,3	0,1	0,7	91,8	100

Tabela 9: Struktura e tabelës së burimeve për vitin 2011 sipas aktiviteteve (%)

Aktivitete (NVE) Produkte (CPA)	Bujqësia, peshkimi gjuetia dhe silvikultura	Industria	Ndërtimi	Tregtia, hotele dhe restorante	Transporti, posta dhe komunikacioni	Shërbime të tjera
Bujqësia, peshkimi, gjuetia dhe silvikultura	72,9	0	0	0	0	0
Industria	27,0	94,9	15,4	0,3	1,1	0
Ndërtimi	0	0,6	73,4	0,4	0	0,4
Tregtia	0,1	3,1	1,4	97,6	1,1	0,4
Transporti, posta dhe komunikacioni	0	1,2	1,6	1,5	96,1	0,1
Shërbime të tjera	0	0,2	8,1	0,1	1,7	99,1
Totali i prodhimit sipas aktiviteteve	100	100	100	100	100	100

Përsa i përket burimeve sipas kategorive ato janë të ndryshme sipas produkteve të caktuara. Në grafikun 4 është bërë një analizë për grup-produktet kryesore të ekonomisë.

Grafiku 4: Burimet sipas kategorive



Në produktet bujqësore vihet re që pjesa më e madhe e këtyre produkteve prodhohen brenda vendit dhe një pjesë e vogël e importuar ndërsa në produktet industriale vihet re një pjesë relativisht e madhe e importuar e burimeve. Më ndryshe shfaqen produktet e ndërtimit të cilat janë pothuajse të gjitha të prodhuara brenda vendit. Kjo vjen për faktin se importi i tyre do të thotë të kemi hyrje të forcës punëtore në ndërtim nga vendet e tjera. Sektorët e tjerë kanë një pjesë relativisht të vogël të burimeve të importuar dhe lidhet kryesisht me importimin e shërbimeve.

Nga ana tjetër tabela e përdorimeve na jep një pamje të qartë të inputeve të përdorura në procesin e prodhimit për secilin aktivitet të ekonomisë. Nga tabela 9 vëmë re se vlerat më të mëdha nuk janë më në diagonale për të gjithë aktivitetet, kjo për faktin se aktiviteti ekonomik mund të përbëhet nga një larmishmëri inputesh të cilat mund të klasifikohen në grupe të tjera produktesh CPA. Avantazhi i kësaj tabele siç e përmendëm edhe më parë lidhet edhe me mundësinë e një vlerësimi më të mirë të konsumit ndërmjetës me çmime konstante. Duke pasur në mënyrë të detajuar strukturat e përdorura në prodhim, përcaktimi i çmimit që përdoret si indeks lidhet me produktin dhe jo me aktivitetin kryesor të ndërmarrjes.

Në tabelën e përdorimeve vihet re që produktet industriale kanë një vlerë shumë më të madhe sesa aktiviteti industrial. Kjo vjen si rezultat i përdorimit të këtyre produkteve nga të gjithë aktivitetet e tjera ekonomike në procesin e tyre të prodhimit. Një fenomen i anasjelltë vihet re në aktivitetin e tregtisë dhe hoteleve, ku konsumi ndërmjetës ka një vlerë shumë më të madhe sesa produkti tregtar. Në këtë rast arsyeja vjen për shkak se produkti tregti (shërbimi tregtar) nuk mund të përdoret si konsum ndërmjetës nga aktivitetet e tjera ekonomike.

Tabela 10: Tabela e përdorimeve me çmime korente për vitin 2011 (milionë lekë)

Aktiviteti (NVE) / Produkte (CPA)	Bujqësia. peshkimi gjuetia dhe silvikultura	Industria	Ndërtimi	Tregtia. hotele dhe restorante	Transporti. posta dhe komunikacioni	Shërbime të tjera	Totali i konsumit ndërmjetës sipas produkteve	Eksportet FOB	Konsumi Final i Familjeve dhe Qeverisë	FKFB dhe Ndryshimi i Gjendjeve	Totali i Përdorimeve
Bujqësia, peshkimi, gjuetia dhe silvikultura	68.954	24.181	773	12.669	8	726	107.310	4.021	206.245	9.406	326.982
Industria	20.478	198.092	253.795	65.646	59.715	63.638	661.363	193.153	456.794	112.463	1.423.773
Ndërtimi	180	4.282	28.878	754	2.788	7.992	44.873	8.519	532	304.843	358.766
Tregtia, hotele dhe restorante	321	525	294	256	1.806	5.569	8.773	57.904	53.534	0	120.211
Transporti, posta dhe komunikacion	2.098	14.496	7.439	4.175	32.375	15.072	75.654	94.969	84.822	0	255.445
Shërbime të tjera	3.926	19.920	19.550	18.053	33.945	65.637	161.033	83.825	364.907	2.782	612.547
Totali i konsumit ndërmjetës sipas aktiviteteve	95.958	261.497	310.729	101.553	130.637	158.633	1.059.007	442.390	1.166.834	429.494	3.097.724

Koncepti i aktivitetit me produktin është shumë më dallueshëm në matricën e konsumit ndërmjetës. Nëse tek matrica e prodhimit vlerat më të mëdha ishin të pozicionuara në diagonale, kjo mund të mos jetë e vërtetë në matricën e konsumit ndërmjetës. Kjo analizë vihet re më qartë në grafikun 5 ku është paraqitur konsumi ndërmjetës sipas aktiviteteve kryesore ekonomike dhe produkteve homogjenë të përdorura në ekonomi si konsum ndërmjetës.

Grafiku 5: Produktet homogjene dhe aktivitetet ekonomike të konsumit ndërmjetës





Tabela e përdorimeve përmban të gjithë komponentët e kërkesës së një ekonomie. Me interes do të ishte një analizë e përdorimeve të çdo produkti sipas kategorive të kërkesës. Nëse i referohemi grafikut 6 shohim që për produktet bujqësore komponenti më i rëndësishëm janë familjet, për produktet industriale pjesa më e madhe e tyre shkon për konsum ndërmjetës dhe për produktin e ndërtimit vlera më e madhe shkon në formim kapitali. Produktet e tjera të ekonomisë kanë një diversifikim më të barabartë të përdorimit të tyre në ekonomi.

Grafiku 6: Përdorimet sipas kategorive për vitin 2011



Analizën që bëmë për tabelën e përdorimeve mbi strukturën e matricës së prodhimit mund ta zhvillojmë edhe mbi matricën e konsumit ndërmjetës. Kjo tabelë jep një pamje më të qartë të përdorimit të produktit në aktivitetet e ekonomisë si konsum ndërmjetës (tabela 10) dhe nga ana tjetër jep një pamje të qartë të inputeve që i duhen një aktiviteti ekonomik për të kryer procesin e prodhimit (tabela 11).

Tabela 11: Struktura e tabelës së përdorimeve për vitin 2011 sipas produkteve (%)

Aktivitete (NVE) Produkte (CPA)	Bujqësia, peshkimi gjuetia dhe silvikultura	Industria	Ndërtimi	Tregtia, hotele dhe restorante	Transporti, posta dhe komunikacion	Shërbime të tjera	Totali i konsumit ndërmjetës sipas produkteve
Bujqësia, peshkimi gjuetia dhe silvikultura	64,3	22,5	0,7	11,8	0,0	0,7	100
Industria	3,1	30,0	38,4	9,9	9,0	9,6	100
Ndërtimi	0,4	9,5	64,4	1,7	6,2	17,8	100
Tregtia, hotele dhe restorante	3,7	6,0	3,4	2,9	20,6	63,5	100
Transporti, posta dhe komunikacion	2,8	19,2	9,8	5,5	42,8	19,9	100
Shërbime të tjera	2,4	12,4	12,1	11,2	21,1	40,8	100

Tabela 11 gjen një përdorim shumë të madh nga studiuesit e ekonomisë pasi jep një pamje të qartë të përqëndrimit të faktorëve të prodhimit në sektorë të ndryshëm të saj. Kështu për shembull nëse do të analizonim sektorin e ndërtimit vëmë re se në këtë proces 81,5 % e kostove janë produkte industriale dhe pjesa tjetër janë produkte të tjera, kryesisht në shërbime.

Tabela 12: Struktura e tabelës së përdorimeve për vitin 2011 sipas aktiviteteve (%)

Aktivitete (NVE) Produkte (CPA)	Bujqësia, peshkimi gjuetia dhe silvikultura	Industria	Ndërtimi	Tregtia, hotele dhe restorante	Transporti, posta dhe komunikacion	Shërbime të tjera
Bujqësia, peshkimi gjuetia dhe silvikultura	71,9	9,2	0,2	12,5	0,0	0,5
Industria	21,3	75,8	81,7	64,6	45,7	40,1
Ndërtimi	0,2	1,6	9,3	0,7	2,1	5,0
Tregtia, hotele dhe restorante	0,3	0,2	0,1	0,3	1,4	3,5
Transporti, posta dhe komunikacion	2,2	5,5	2,4	4,1	24,8	9,5
Shërbime të tjera	4,1	7,6	6,3	17,8	26,0	41,4
Totali i konsumit ndërmjetës sipas aktiviteteve	100	100	100	100	100	100

Analiza e mësipërme është përqëndruar vetëm në rezultatet e vitit 2011. Siç e përmendëm edhe më sipër këto tabela janë vlerësuar për periudhën 2009-2011 dhe janë të disponueshme në një nivel më të detajuar matricor.

Tabelat e konsoliduara të TBP-ve janë baza nga mund të derivohen tabelat simetrike të input-outputeve. Në parim tabela input-output paraqet të njëjtët transaksione si tabela e burimeve dhe përdorimeve por ka dy dallime thelbësore:

Së pari në mënyrën e ndërtimit duhet të jetë gjithmonë e rendit n*n dhe së dyti në rreshtat dhe kolonat e kuadratit të ndërmjetëm të kenë të njëjtin dimension, industri-për-industri ose produkt-për-produkt duke na dhënë produkte ose aktivitete homogjene në varësi të supozimit.

Puna për ndërtimin e këtyre tabelave ka filluar në IPA 2007 së bashku me tabelat e Burimeve dhe Përdorimeve, është punuar në një nivel detajimi prej 25 aktivitetesh, por mungesa e vlerësimeve të PBB-së me metodën e të ardhurave dhe mungesa e të dhënave për një vlerësim të saktë të përdorimeve duke i ndarë në prodhim vendas dhe importe janë një pengesë por dhe një sfidë për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre tabelave.

Në tabelën 13 jepet SIOT sipas modelit M4 duke u bazuar në supozimin e strukturës fikse të shitjeve për produktin që rekomandohet të përdoret pasi nuk kërkon supozime por mbështetet në të dhëna të vrojtuara dhe përdor vetëm të dhënat e TBP-ve, pra nuk kërkon mbledhjen e të dhënave shtesë. Ndryshe nga tabelat e burimeve dhe përdorimeve ku analiza realizohet duke lidhur produktet me aktivitetet, në SIOT analizohet lidhja mes aktiviteteve të ndryshme të ekonomisë.

Tabela 13: Tabela Input-Output për vitin 2011 (milionë lekë)

Produkte (CPA) Produkte (CPA)	Bujqësia, peshkimi gjuetia dhe silvikultura	Industria	Shërbime	Totali i prodhimit sipas produkteve	Kerkesa finale	Totali i Përdorimeve
Bujqësia, peshkimi, gjuetia dhe silvikultura	57.835	23.750	21.549	103.134	254.320	357.454
Industria	15.141	375.340	144.645	535.125	848.140	1.383.266
Shërbime	18.682	123.905	187.548	330.135	857.366	1.187.502
Totali	91.659	522.995	353.742	968.395	1.959.826	2.928.221
Taksa neto mbi produktet	4.299	49.231	37.082	90.612	78.891	169.503
Totali I Konsumit Ndërmjetës/ Përdorimet finale me çmime tregu	95.958	572.226	390.823	1.059.007		3.097.724
Vlera e Shtuar me çmime bazë	237.062	324.244	569.815	1.131.121		
Prodhimi me çmime bazë	333.019	896.470	960.638	2.190.127		
Importet CIF	24.434	486.796	226.863	738.093		
Burimet me çmime bazë	357.454	1.383.266	1.187.502	2.928.221		

Tabela Input-Output janë një instrument shumë i fuqishëm në analizën statistikore me anë të cilëve tregojnë ndryshimet strukturore të ekonomisë. Tabelat input-output ilustrojnë dy efekte kryesore:

Së pari kur një industri rrit prodhimin, një rritje korresponduese e produktit ndodh dhe në industritë furnizuese kështu ndodh një efekt zinxhir ciklik në të gjithë ekonominë.

Efekti i dytë është kur një industri rrit prodhimin i cili çon në një rritje korresponduese të prodhimit të degëve të tjera që këtë output e përdorin si input parësor.

Pra lidhjet midis industrive janë ato të cilat tregojnë rëndësinë relative të këtij sektori në lidhje me ekonominë. Në formulën e mëposhtme do të paraqesim mënyrën e llogaritjes së koeficientëve të lidhjeve midis degëve.

$$a_{ij} = \frac{x_{ij}}{x_j}$$

Dy nga analizat më të përdorura në analizën e tabelave input-output janë Analiza Kosto Çmim dhe Analiza e Impaktit. Analiza Kosto Çmim aplikohet duke u mbështetur në të dhënat e tabelave input-output. Kjo analizë mundëson të studiosh ndikimin e rritjes së çmimit të një produkti p.sh. të naftës në prodhimin e degëve të tjera.

Analiza e impaktit përcakton efektin e ndryshimit të kërkesës finale në prodhimin e të gjithë sektorëve të ekonomisë. Duke qënë se lidhjet ndërmjet sektorëve të ndryshëm të ekonomisë sjellin një efekt zhinxhir, rritja e kërkesës për një produkt do të çonte në rritjen e prodhimit në të gjitha degët e lidhura.

6. Material Metodologjik

Ndërtimi i TBP-ve kërkon që të mblidhen një numër sa më i madh të dhënash në një nivel sa më të detajuar. Burimet e informacionit që përdoren në këtë sistem janë nga më të larmishmet dhe në shumë raste mund të jenë edhe dytësore por që mund të luajnë një rol të rëndësishëm në balancimin e qarkullimit të produkteve. Materiali në vazhdim do të fokusohet në një analizë të detajuar të burimeve të të dhënave dhe metodave të përdorura për secilin komponent të TBP-ve në rastin e Shqipërisë.

6.1. Tabelat e Burimeve dhe Përdorimeve me çmime korente

Sistemi i TBP-ve me çmime korente në Shqipëri është i ndërtuar në një nivel prej 60 produktesh dhe 60 aktivitetesh që korrespondojnë me NVE rev 1.1 dy shifrore. Analizat janë zhvilluar në nivel produkti sipas klasifikimit CPA 2, 4 dhe 6 shifrore duke mundësuar këtë mënyrë një pamje të qartë të qarkullimit të produktit në ekonomi.

Për ndërtimin e TBP-ve në Shqipëri janë kryer një sërë analizash dhe studimesh për të mundësuar një përdorim sa më efiçent të burimeve administrative dhe statistikore. Këto analiza kanë mundësuar përcaktimin më të mirë të mundshëm të informacionit si dhe përdorimin e tyre sa më pranë standardeve ndërkombëtare. Fokus i veçantë i është vënë kryesisht nivelit të detajimit të të dhënave për të kaluar në një detajim sa më të madh të mundshëm. Këto tabela janë ndërtuar për tre vite duke përfshirë periudhën 2009-2011 duke mundësuar në këtë mënyrë një trajtim në kohë të strukturave të produkteve.

6.1.1. Prodhimi

Elementi i parë i tabelës së burimeve është matrica e prodhimit e cila reflekton aktivitetin prodhues të degëve të ekonomisë. Burimi kryesor i të dhënave për shpërndarjen e prodhimit në tabelën e burimeve është ASN-ja. Totali i prodhimit për çdo degë në nivel klasifikimi NVE 2 shifrore merret nga vlerësimet e PBB-së me metodën e prodhimit. Për secilën nga aktivitetet e mbuluara nga ASN, trajtohet struktura e shifrës së afarizmit në nivel ndërmarrje. Informacioni fillestar merret në nivelin e paraqitur si në tabelën 12 për çdo ndërmarrje dhe trajtohet në nivel të detajuar për çdo aktivitet ekonomik sipas klasifikimit NVE Rev1.1 dy shifrore.

Tabela 14: Ndarja e shifrës së afarizmit

Nr.	Aktiviteti	Kodi NVE 4 shifror	Totali Shifrës së Afarizmit (Mijë lekë)	Numri mesatar i punonjësve
1				
2				
3				
4				

Përveç trajtimit në nivel 4 shifror për pjesën e produkteve industriale nga ASN shfrytëzohet edhe një informacion më i detajuar në nivel 6 shifrorë, sipas nomenklaturës CPA, i cili lidhet me produktet e prodhuara nga çdo ndërmarrje në ekonomi. Ky informacion është i disponueshëm në nivel ndërmarrje siç paraqitet në tabelën 15.

Tabela 15: Lista e produkteve industriale

Nr.	Kodi i produktit sipas Nomenklaturës së produkteve	Emërtimi i produktit	Njësia e matjes	Sasia			Shitje në vlerë pa TVSH (në mijë lekë)
				Prodhim	Shitje	Gjendje në fund	
1							
2							
.....							
....							
n							

Përpara se të bëhet shpërndarja e vlerës së prodhimit sipas produkteve për secilin aktivitet ekonomik paraprakisht bëhen kontrollet në nivel ndërmarrje për të mundësuar barazimin e vlerave përkatëse.

$$T_{P_i} = \sum T_{P_{ij}} \text{ dhe } T_{P_{ij}} = \sum T_{P_{ijk}} \qquad \text{(ek. 1)}$$

Ku:
TPi – Vlera totale e prodhimit për çdo ndërmarrje klasifikuar në aktivitetin "i".
TPij – Vlera e prodhimit për çdo aktivitet katërshifror "j" me aktivitet kryesor i.
TPijk – Vlera e prodhimit për çdo produkt gjashtëshifror "k" me aktivitet kryesor i dhe aktivitete dytësore j.

Në këtë mënyrë për secilën ndërmarrje bëhet kontrolli që vlerat e deklaruara për prodhimin e produkteve të jenë të barabarta me aktivitetin që ato i përkasin dhe që shuma e të gjithë aktiviteteve të barazohet me totalin që ndërmarrja ka deklaruar. Në hapin tjetër për ndërmarrjet e klasifikuara në të njëjtin aktivitet ekonomik 2 shifrorë përcaktohet struktura që zë secili produkt ndaj totalit të vlerës së deklaruar. Kjo strukturë përdoret më pas për të shpërndarë prodhimin total të aktivitetit ekonomik sipas produkteve të aktiviteteve.

$$V_{P_{ijk}} = \frac{T_{P_{ijk}}}{\sum T_{P_{ijk}}} * T_{P_D} \qquad \text{(ek. 2)}$$

Ku:
VPijk – Vlera totale e prodhimit për produktin "k" në aktivitetin "i".
TPD – vlera totale e prodhimit të aktivitetit "i".

Nisur nga këto vlerësime të kryera në nivel ndërmarrje mundësohet që të kemi një unifikim të informacionit për çdo aktivitet ekonomik dhe të jemi në gjendje që të vlerësojmë totalin e produktit homogjen të prodhuar në vend pavarësisht se kush ka qenë aktiviteti ekonomik primar që e ka prodhuar këtë produkt. Metoda e përshkruar më sipër përdoret për të gjitha aktivitetet ku si burim primar i informacionit është ASN. Për aktivitetet e tjera të cilat nuk mbulohen nga kjo anketë logjika që përdoret është e njëjtë por duke respektuar detajimin e informacionit që është në dispozicion nga burimet alternative. Gjithashtu duhet të theksohet fakti se përveç informacionit bazë që përdoret për shpërndarjen e prodhimit të ndërmarrjeve, kryesisht siç paraqitet në tabelën 14 dhe 15 përdoret dhe informacion i marrë nga baza e të dhënave të eksporteve në nivel ndërmarrje.

Ky informacion përdoret për të përmirësuar shpërndarjen e prodhimit sipas produkteve pasi mund të ketë raste që një ndërmarrje prodhuese ka deklaruar shifër afarizmi por nuk ka plotësuar listën e produkteve të prodhuara (tabela 15). Nisur nga informacioni i deklaruar në të dhënat e eksporteve bëhet e mundur një shpërndarje e prodhimit të ndërmarrjes sipas rastit. Në tabelën 16 jepet një përmbledhje e burimeve të informacioneve të përdorura për shpërndarjen e prodhimit sipas produkteve për secilin aktivitet ekonomik.

Tabela 16: Burimet e përdorura për shpërndarjen e prodhimit sipas aktiviteteve

Përshkrimi	NVE 2 shifrore	Burimi i të dhënave
Bujqësia	01,02	Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në INSTAT
Peshkimi	05	ASN
Industria	10-40	ASN
Energjia	41	ASN
Ndërtimi	45	ASN
Tregtia, hotele dhe restorante	50-55	ASN
Transporti	60-64	ASN
Aktivitete Financiare	65-67	Pasqyrat Financiare të bankave.
Renta e Inputuar dhe Aktivitete të tjera të biznesit	70	Prodhimi për aktivitetin 70 (NVE) përbëhet nga renta e inputuar dhe aktivitete të tjera të bizneseve. Vlera e rentës së inputuar vendos et në diagonale pasi është prodhim homogjen ndërsa për pjesën tjetër të aktivitetit 70 është shpërndarë sipas strukturës që vjen nga ASN.
Dhënia me qera e pajisjeve dhe kërkim zhvillime	71-73	Për aktivitet NVE 71-73 është përdorur struktura që vjen nga ASN, vetëm për aktivitetin NVE 73 në mungesë të informacionit vlera është vendosur në diagonale.
Aktive të tjera profesionale	74	ASN, Pasqyrat Financiare dhe studime nga informacione alternative
Administrata Publike, Shëndetësia dhe Arsimi	75, 80, 85	Ministria e Financave, ASN dhe Pasqyrat Financiare
Shërbimet	90-99	Pasqyrat Financiare dhe studime nga informacione alternative

Nga tabela shohim që disa prej sektorëve të ekonomisë nuk mbulohen nga ASN. Ndër këta sektorë mund të përmendim:

- Sektori i Bujqësisë – Të dhënat merren nga sektori i bujqësisë në nivel produkti dhe më pas kodifikohen sipas nomenklaturës së produkteve (CPA), struktura e të cilëve shërben për të shpërndarë vlerën totale të prodhimit në këtë sektor;
- Aktiviteti Financiar – Për aktivitetet financiare informacioni mblidhet nga pasqyrat financiare të bankave të nivelit të dytë dhe trajtohet në nivel ndërmarrje (në këtë rast banka). Kjo strukturë përdoret për të gjithë aktivitetin financiar pasi bankat e nivelit të dytë përbëjnë komponentin kryesor të këtij aktiviteti;
- Për administratën publike, arsimin dhe shëndetësinë të dhënat merren nga Ministria e Financave në nivel institucioni. Pjesa e arsimit dhe shëndetësisë private duke qenë se ka një natyrë për prodhim tregu trajtohet si aktivitetet e tjera për prodhim tregu. Informacioni për trajtimin e tyre merret nga ASN dhe pasqyrat financiare të bizneseve.

6.1.2. Importi

Komponenti tjetër i matricës së burimeve është matrica e importeve, e cila është një matricë vektoriale. Importet në total janë të përbëra nga dy grupe kryesore, pjesa e të mirave dhe pjesa e shërbimeve. Importi i një të mire ndodh kur ka një ndryshim pronësie nga një jo-rezidentë drejt një rezidenti dhe nuk kërkon detyrimisht që produkti të kalojë fizikisht kufirin. Ndërsa si import shërbimesh regjistrohet çdo blerje direkte nga rezidentët jashtë territorit ekonomik të një vendi.

Informacioni për importin e të mirave vjen nga sektori i tregtisë së jashtme i klasifikuar sipas Nomenklaturës së Kombinuar 8-shifrore (CN) duke mundësuar në këtë mënyrë një trajtim të plotë të tyre. Më pas duke përdorur korrespondencën e nomenklaturave CN-CPA kalohet në një nivel më të agreguar. Për vlerësimin e importit të shërbimeve informacioni merret nga Bilanci i Pagesave (BoP), i vlerësuar nga Banka e Shqipërisë. Informacioni nga BoP merret sipas kategorive si në tabelën 15 dhe më pas duke u mbështetur mbi lidhjen konceptuale që ekziston ndërmjet ESA dhe BoP, përdoren disa struktura për ti kaluar në produkte specifike sipas kategorive të paraqitura në kolonën e dytë të tabelës 15.

Tabela 17: Niveli i detajimit të importit të shërbimeve

Grupi		Kodi i produktit (CPA)
1.	Shërbime transporti	
1.1.	Shërbime transporti ujor	61.10
1.2.	Shërbime transporti ajror	62
1.3.	Shërbime transporti rrugor	60
1.4.	Shërbime transporti hekurudhor	60
2.	Shërbime udhëtimi	
2.1.	Udhëtime biznesi	
2.1.1.	Shpenzimet e punonjësve sezonal dhe jashtë kufijve	55, 52, 60, 63
2.1.2.	Të tjera udhëtime biznesi	64, 92, 93
2.2.	Udhëtime personale	
2.2.1.	Shërbime të lidhura me shëndetësinë	85
2.2.2.	Shërbime të lidhura me edukimin	80
2.2.3.	Shërbime të tjera	55, 52, 60, 63, 71, 92, 64, 65
3.	Shërbime komunikimi	64
4.	Shërbime ndërtimi	45
5.	Shërbime sigurimi	66, 67
6.	Shërbime financiare	65
7.	Shërbime kompjuterike dhe informatike	72, 92, 74
8.	E drejta e autorit dhe liçencat	
8.1.1.	Franchise dhe të drejta të ngjashme	74
8.1.2.	Honorare dhe tarifa për liçenca	74
9.	Shërbime të tjera biznesi	
9.1.	Shërbime të tregtare	50, 51
9.2.	Shërbimet e leasing-ut operativ	71
9.3.	Shërbime të ndryshme biznesi, profesionale, teknike	
9.3.1.	Marrëdhëniet me publikun dhe shërbime të konsultimit ligjor, menaxhimi, kontabiliteti, etj.	74, 73, 90
9.3.2.	Shërbimet të argëtimit, kulturore dhe personale	80, 85, 92, 93
9.3.3.	Shërbime qeveritare	75

Duke qenë se importi i të mirave vjen në një nivel të lartë detajimi duke përdorur korrespondencat midis nomenklaturave të ndryshme informacioni mund të përdoret edhe për analiza dhe studime mbi komponentë të tjerë të TBP-ve. Një shembull është edhe përdorimi i klasifikimit CN-BEC (Tabela 21) për të mësuar qëllimin final të importit të të mirave. Duke shfrytëzuar numrin identifikues të ndërmarrjes importuese mund të analizohet pjesa e konsumit të ndërmjetëm të importuar, apo pjesa e produkteve të importuara që shkon për konsumin e familjeve dhe për formimin bruto të kapitalit. Duke qenë se importet janë në vlera CIF është e rëndësishme që të bëhet edhe kalimi i tyre në vlera FOB .

Statistikat doganore vlerësojnë importin e të mirave në CIF, që do të thotë se çmimi i transportit dhe siguracionit i ngarkohet vendit importues në kufi. Për të vlerësuar importin e të mirave në çmime FOB[1] duhet zbritur vlera e shërbimit të siguracionit dhe transportit midis kufijve të vendit eksportues dhe atij importues. Për të parë mundësinë e një rregullimi më të saktë dhe në një nivel më të detajuar produkti CIF-FOB, u përdorën të dhënat administrative mbi importin e të mirave të vitit 2010, marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Në studim u morën vetëm ato grupe produktesh CN 8 shifrore që kanë një numër transaksionesh më të madh se 30 (për tu përafruar me shpërndarjen normale) dhe që kanë plotësuar informacion mbi transportin dhe siguracionin në deklaratat doganore. Nga të dhënat për çdo produkt u bë eliminimi i vlerave me impakt sipas metodës BOX – PLOT të John Tukey[2]. Pas aplikimit të kësaj metode u morën në studim 2.305 produkte CN 8 shifrore për transportin dhe 2.636 produkte CN 8 shifrore për siguracionin. Ndërtimi i koeficientëve u bë në nivel 2 shifror të CPA 2002.

6.1.3. Marzhi Tregtar

Marzhi tregtar është një nga komponentët për kalimin e tabelës së burimeve nga çmime bazë në çmime të blerësit dhe tabelës së përdorimeve nga çmimet e blerësit në çmime bazë. Marzhi tregtar është prodhimi i aktivitetit të tregtisë më shumicë dhe tregtisë me pakicë. Meqenëse tregtia trajtohet si shërbim, totali i prodhimit do të jetë i barabartë me vlerën totale të marzheve të mallrave të blera për rishitje. Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare (ESA 2010)[3] e përkufizon marzhin tregtar si diferencë midis çmimit aktual ose të inputuar të një produkti të blerë për rishitje, dhe çmimit që do të paguhej për zëvendësimin e produktit në momentin e shitjes.

[1] FOB (Free on Board-ang) përfshin në kostot e mallrave të gjitha shpenzimet e kryera deri në portin e fundit
[2] të vendit nisës së mallrave dhe shërbimeve
[2] Shih "Exploratory Data Analysis" tek referencat
[3] ESA2010 Sistemi Evropian i Llogarive Ekonomike

Vlerësimi i marzhit tregtar shpesh del si një detyrë e vështirë dhe kjo vjen si pasojë e gamës të ndryshme të produkteve, marzheve të ndryshme të produkteve në ndërmarrjet tregtare po ashtu edhe kanaleve të ndryshëm për qarkullimin e produkteve. Kështu lind nevoja e ndërtimit të disa hipotezave të cilat na çojnë sa më afër realitetit, gjithashtu krijimit të lidhjeve për përdorimin e disa burimeve të ndryshme të dhënash për vlerësimin e marzhit tregtar. Duke përdorur të dhënat që ndërmarrjet raportojnë nëpërmjet bilanceve dhe ASN-së mund të vlerësojmë prodhimin e tregtisë i cili është i barabartë me shumën e prodhimit të ndërmarrjeve që klasifikohen si ndërmarrje tregtare me pakicë dhe shumicë (NVE 50, 51 dhe 52) duke shtuar dhe prodhimin e tregtisë të ndërmarrjeve që e kanë tregtinë si aktivitet dytësor. Ekuacioni[1] për vlerësimin e marzhit tregtar është si më poshtë:

$$M_t = \sum_i Ts_i - Pr_i + NI_i \qquad \text{(ek.3)}$$

Ku:
i = 1, … , n, prezanton n produktet që një firmë tregtare ka për rishitje
Mt – marzhi tregtar
Ts – totali i shitjeve nga ndërmarrjet tregtare
Pr – vlera e mallrave të blera për rishitje
NI – ndryshimi në gjendjen e mallrave (ndryshimi në inventar)

Për të vlerësuar përqindjen e marzhit tregtar është llogaritur prodhimi i çdo ndërmarrje tregtare që është totali i marzhit për n produktet që ndërmarrja tregton ndaj shitjeve totale të saj.

$$\%\ \mathrm{Mt} = \frac{\mathrm{Mt}}{\mathrm{Ts}} \qquad \text{(ek.4)}$$

Pasi vlerësohet marzhi tregtar në nivel ndërmarrje këtë e marrim si pikënisje për vlerësimin e marzhit tregtar në bazë produkti për gjithë ekonominë e vendit. Metoda e përdorur është shpjeguar më poshtë në katër hapa kryesor.

Hapi i parë është përcaktimi i përqindjes së marzhit tregtar për ndërmarrje. Ndërmarrjet e marra në studim i ndajmë në tre grupe, NVE 50 (shitja, mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve motorike dhe shitja me pakicë e karburanteve), NVE 51 (tregtia me shumicë) dhe NVE 52 (tregtia me pakicë). Nga të dhënat vjetore të ndërmarrjeve tregtare (ASN dhe bilance) kemi marrë në studim 7.592 ndërmarrje që kanë dhënë informacion. Për të gjitha ndërmarrjet u përcaktua norma e marzhit dhe nga studimet që u bënë u vu re se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve ishin të përqendrua në intervalin [3 % deri 50 %] të cilat u morën edhe për këtë qëllim.

[1] Shih "The Impact of Trade Margins Matrix on the Statistical Sources., (p. 3)" në referencat.

Hapi i dytë është shpërndarja e marzhit tregtar të ndërmarrjes sipas grup produkteve CPA 2 shifror, pra për i produkte që ndërmarrja ka për rishitje. Ndërmarrjet tregtare janë marrë në studim në klasa NVE 4 shifror, pra janë në nivel të detajuar dhe ndërmarrjet brenda të njëjtës klasë tentojnë drejt specializimit pra tregtojnë të njëjtin grup - produktesh.

Nga baza e të dhënave të importeve kemi marrë të gjitha produktet që importohen për rishitje nga ana e kompanive tregtare, dhe nga këto produkte për rishitje kemi përcaktuar raportin që tregtohet çdo grup produkt në një klasë të tregtisë.

Hapi tjetër është transformimi i matricës së prodhimit dhe shitjeve të klasave të tregtisë duke i shumëzuar raportet që një produkt tregtohet në një klasë me prodhimin dhe shitjen e klasës. Pasi kemi përcaktuar degët dhe përqindjet në çdo klasë, këto përqindje janë aplikuar mbi prodhimin e tregtisë dhe shitjeve duke na dhënë në këtë mënyre marzhet e tregtimit të grup - produkteve në klasa të ndryshme. Shpërndarja e prodhimit dhe shitjeve sipas peshave të tregtimit të një produkti në një klasë të tregtisë çon në ndikime të ndryshme në përqindjen e marzhit të produktit si pasojë e peshës së produktit dhe peshës së degës.

Hapi i fundit është përcaktimi i kanaleve qarkullues të tregtimit të produkteve. Ky është një nga detyrat më të vështira së bashku me përcaktimin e përqindjeve të tregtimit të secilit produkt në klasat e tregtisë. Kanalet shpërndarës janë një nga komponentët më të panjohur për ndërtimin e matricës së marzheve tregtar. Zakonisht blerësve nuk u intereson dhe nuk e dinë nëse një produkt është shitur nëpërmjet kanaleve të shitjes me pakicë apo me shumicë. Në studime të ndryshme të bëra në fushën e tregtisë[1], janë përcaktuar disa kanale kryesor të kalimit të një produkti deri në destinacionin final të tij.

Për këtë qëllim janë vlerësuar 11 kanale kryesorë të shpërndarjes së produkteve, në bazë të të cilëve përcaktohet dhe marzhi. Nisur nga kalimi i një produkti mund të kemi katër situata të ndryshme:

- një produkt mund të mos kaloj nëpërmjet kompanive tregtare dhe në këtë rast nuk kemi marzh të shtuar (kanalet 1, 2 dhe 11),
- mund të kaloj nëpërmjet një hallke tregtare (kanalet 3, 8 dhe 9),
- mund të kaloj nëpërmjet 2 hallkave tregtare (kanalet 5, 6 dhe 7)
- mund të kaloj nëpërmjet 3 hallkave tregtare (kanalet 4 dhe 11).

[1] Shih "A Use-Side Procedure for Estimating Trade Margin in Input-Output Analysis" tek referencat

Tabela 18: Kanalet shpërndarës të produkteve

Nr	Kanali	
1	Import	Importues → Konsumator
2	Prodhim	Prodhues → Konsumator
3	Prodhim	Prodhues → Tregtues Pakicë→ Konsumator
4	Prodhim	Prodhues →Tregtues Shumicë→ Tregtues Shumicë→ Tregtues Pakicë→ Konsumator
5	Prodhim	Prodhues → Tregtues Shumicë→ Tregtues Shumicë→ Konsumator
6	Import	Tregtues Shumicë → Tregtues Pakicë→ Konsumator
7	Prodhim	Prodhues → Tregtues Shumicë→ Tregtues Pakicë→ Konsumator
8	Import	Tregtues Shumicë → Konsumator
9	Prodhim	Prodhues → Tregtues Shumicë→ Konsumator
10	Import	Tregtues Shumicë → Tregtues Shumicë→ Tregtues Pakicë→ Konsumator
11	Prodhim	Prodhues → Eksport

Nga kanali qarkullues nëpërmjet të cilit produkti kalon për tek konsumatori final që mund të jenë familjet, ndërmarrjet apo qeverisja qendrore ose lokale në mënyrë progresive akumulohet edhe marzhi tregtar në çmimin e blerësit. Për të gjithë kanalet qarkullues të produkteve më poshtë paraqesim formulat për llogaritjen e marzhit me shumicë dhe pakicë.

Tabela 19: Përcaktimi i marzhit të tregtisë për çdo kanal qarkullues

Kanali	% e marzhit total (r + w)	Pakicë	Shumicë
1	0	0	0
2	0	0	0
3	ri	ri	0
4	ri+wi (1 - ri)(2 - wi)	ri	wi (1 - ri)(2 - wi)
5	wi (2 - wi)	0	wi i(2 - wi)
6	ri+ wi - ri wi	ri	wi – ri wi
7	ri+ wi - ri wi	ri	wi – ri wi
8	wi	0	wi
9	wi	0	wi
10	ri+ wi (1 - ri)(2 - wi)	ri	wi (1 - ri)(2 - wi)
11	0	0	0

Nga të dhënat e ASN-së kemi marrë tabelën e detajimit të shitjeve sipas klientëve kryesor, e plotësuar nga 7.206 ndërmarrje për vitin 2011. Nga këto të dhëna janë përcaktuar kanalet qarkulluese të mallrave, të cilët kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerën totale të produktit për rishitje.

Pasi përcaktuam kanalet qarkulluese për secilin grup - produkt nga përqindjet e të ardhurave sipas klientëve kryesor, totali i importeve dhe prodhimit u shpërnda sipas përqindjeve të kanalit. Në këtë mënyrë duke shumëzuar përqindjen e tregtimit të produktit në një kanal qarkullues me prodhimin dhe importin e këtij kanali përftojmë marzhin e tregtisë për secilin kanal qarkullues. Marzhi total nëpërmjet të cilëve një produkt qarkullon është i barabartë me marzhin total për këtë produkt.

6.1.4. Marzhi i Transportit

Marzhi i transportit[1] përfshin koston e transportit të paguar më vete nga blerësi të përfshira në përdorimet me çmime të blerësit por jo në outputin e prodhuesit me çmime bazë apo në marzhin tregtar të tregtuesve me shumicë ose pakicë. Marzhet e transportit më saktësisht përfshijnë:

- Transportin e produkteve nga vendi ku janë prodhuar në vendin ku blerësi i merr në dorëzim, në rastet kur prodhuesi paguan pjesën e transportit deri në vendin ku blerësi merr dorëzimin me kusht që të jetë faturuar më vete për blerësin;
- Transporti i produkteve i organizuar nga prodhuesi, tregtuesi me shumicë apo pakicë në mënyrë që blerësi të paguajë për koston e transportit më vete edhe në rastet kur transporti kryhet nga prodhuesi apo tregtuesi;
- Të gjitha kostot e tjera të transportit të produkteve nuk regjistrohen si marzh transporti.

Si bazë për vlerësimin e marzheve të transportit merren shpenzimet e transportit të ndërmarrjeve nga bilancet dhe ASN dhe baza e të dhënave të importeve dhe eksporteve nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Në tabelën 20 jepen matricat vektoriale të marzheve të tregtisë dhe transportit sesi integrohen në sistemin e TBP-ve.

Tabela 20: Marzhet e tregtisë dhe transportit - burimet

Aktiviteti (NVE) Produktet (CPA)	Tregtia me shumicë	Tregtia me pakicë	Transporti	Marzhi i tregtisë dhe transportit
1 2 … … … … n-1 n				Marzhi i tregtisë dhe transportit sipas produkteve
Totali	Totali tregtisë me shumicë	Totali tregtisë me pakicë	Totali i transportit	Totali i marzheve në burime sipas produkteve

Hapi i parë është vlerësimi i marzhit të jashtëm të transportit, nga baza e të dhënave të importeve dhe eksporteve të produkteve. Në deklaratën doganore ndërmarrjet janë të detyruara të deklarojnë dhe kostot e transportit nga e cila janë marrë të gjitha produktet e importuara nga ndërmarrjet në nivel të detajuar CN 8 dhe kostot e transportit për secilin nga produktet, dhe në këtë mënyrë duke pjesëtuar koston e transportit ndaj vlerës së produktit përfitojmë përqindjen e marzhit tregtar për secilin produkt.

Për produktet në nivel CN 8 shifror është bërë një analizë për shpërndarjen e marzheve të transportit dhe eliminimit të vlerave të largëta ku u morën në studim rreth 395.000 transaksione të cilat u grupuan sipas CN 8 shifror në 6.501 produkte. Nisur nga lidhja që ekziston ndërmjet CPA dhe CN u bë kalimi i informacionit në nivel CPA 2 shifror për të cilët u përcaktuan edhe normat e marzhit të transportit duke pjesëtuar koston e transportit me vlerën e produktit.

[1] Referuar manualit ESA2010 faqe 283

Hapi i dytë është vlerësimi i marzhit të brendshëm të transportit nga shpenzimet e transportit të ndërmarrjeve të deklaruara në ASN dhe bilance. Në analizë u morën 1.733 ndërmarrje të cilat kishin lidhje me bazën e të dhënave të importit. Nga totali i shpenzimeve të transportit të deklaruar në ASN dhe bilance u zbritën shpenzimet e jashtme të transportit dhe diferenca u trajtua si transport i brendshëm. Ndërmarrjet e marra në studim u grupuan sipas NVE 2 shifror duke mbledhur dhe prodhimin e këtyre ndërmarrjeve dhe shpenzimet e transportit. Duke pjesëtuar kostot e transportit për secilin grup, me prodhimin u mor përqindja e brendshme e marzhit të transportit për çdo produkt në CPA 2 shifrore.

Hapi i fundit është vlerësimi i marzhit të transportit si total i cili është shuma e marzhit të brendshëm dhe të jashtëm. Marzhi i jashtëm vlerësohet duke shumëzuar përqindjen respektive të marzhit me importet e secilit produkt, ndërsa për marzhin e brendshëm të produkteve shumëzojmë përqindjen e marzhit të brendshëm të çdo produkti me prodhimin dhe importet por duke i zhveshur këta nga ajo pjesë që ndërmarrja e përdor për konsum ndërmjetës. Totali i marzhit të jashtëm dhe të brendshëm na jep marzhin total të transportit.

6.1.5. Taksat dhe subvencionet mbi produktet

Procesi i transformimit nga çmime bazë në çmime blerësi në sistemin e TBP-ve kërkon jo vetëm një shpërndarje të marzhit të tregtisë dhe transportit por edhe integrimin e taksave dhe subvencioneve mbi produktet. Taksa neto (taksa minus subvencione) mbi produktet janë pjesë e tabelës së burimeve dhe përfshijnë:

- Tatimin mbi vlerën e shtuar mbi produktet e prodhuara në vend;
- Tatimin mbi vlerën e shtuar mbi produktet e importuar;
- Akciza mbi produktet e prodhuara në vend;
- Akciza mbi produktet e importuar;
- Taksa të tjera mbi produktet e prodhuara në vend;
- Taksa doganore mbi produktet e importuara;
- Subvencionet mbi produktet;

Burimet e të dhënave për vlerësimin e taksave neto mbi produktet janë Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për produktet e prodhuara dhe të tregtuara në vend dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për produktet e importuara. Vlerësimi i taksave mbi produktet e importuara, bëhet në nivelin më të detajuar të mundshëm, në nivel transaksioni për produkte sipas klasifikimit CN 8 shifrore duke përdorur procedurat e zgjeruara të sistemit të doganave, dhe më pas nëpërmjet korrespondencave përkatëse bëhet kalimi në të njëjtin nivel detajimi si tabela e burimeve. Ndërkohë niveli i detajimit të taksave mbi produktet e prodhuara në vend është shumë më i agreguar, TVSH dhe subvencionet kanë një nivel detajimi 4 shifrorë sipas klasifikimit NVE ndërsa taksat e tjera një detajim 2 shifrorë sipas klasifikimit CPA.

6.1.6. Konsumi i ndërmjetëm

Konsumi ndërmjetës është një nga komponentët më të rëndësishëm të tabelës së përdorimeve. Shpërndarja e tij sipas produkteve kërkon një informacion shumë të hollësishëm nga ndërmarrjet. Kjo do të thotë që për çdo ndërmarrje të kemi informacion mbi lëndën e parë që ajo përdor në prodhim në nivel produkti si dhe të njihet përpjesa që zë ajo në totalin e shpenzimeve për konsum ndërmjetës. Po ashtu duhet që të disponohet informacion i detajuar edhe mbi shpenzimet operative që kryen ndërmarrja si shpenzimet për energji elektrike, qira, transport, telekomunikacion, etj, për të plotësuar strukturën e plotë të shpenzimeve për çdo ndërmarrje.

Pra vlerësimi i matricës së konsumit ndërmjetës kërkon që ndërmarrjet të raportojnë një bilanc të hollësishëm të të gjitha shpenzimeve që kryejnë. Burimi kryesor për shpërndarjen e konsumit të ndërmjetëm në tabelën e përdorimeve është ASN. Informacioni specifik është marrë nga tabela e strukturës së kostos që përmban kjo anketë e cila është në një nivel detajimi 2 shifror të CPA-së. Gjithashtu për të mundësuar një informacion sa më të plotë për çdo ndërmarrje janë analizuar shpenzimet të paraqitura në pasqyrat e të ardhura-shpenzimeve të plotësuara në ASN ose bilance. Një tjetër analizë kontrolluese bëhet edhe me bazën e të dhënave të importeve duke parë produktet që kjo ndërmarrje ka importuar për konsum të ndërmjetëm dhe nuk i ka deklaruar në strukturën e kostos në ASN. Si edhe në rastin e matricës së prodhimit për aktivitetet që nuk mbulohen nga ASN janë përdorur burime alternative sipas aktivitetit përkatës. Tabela 21 jep një pamje të përgjithshme të burimeve të përdorura.

Tabela 21: Burimet e përdorura për shpërndarjen e konsumit të ndërmjetëm

Përshkrimi	NVE 2-shifrore	Burimi i të Dhënave
Bujqësia	01; 02	Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në INSTAT
Peshkimi	05	ASN
Industria	10-37	ASN & Pasqyrat Financiare
Energjia dhe Uji	40-41	ASN & Pasqyrat Financiare
Ndërtimi	45	ASN & Pasqyrat Financiare
Tregti, hotele dhe restorante	50-55	ASN & Pasqyrat Financiare
Transporti	60; 61; 63; 64	ASN & Pasqyrat Financiare
Transporti Ajror	62	Pasqyrat Financiare
Aktivitete Financiare	65-67	Pasqyrat Financiare
Renta e Imputuar dhe Aktivitete të tjera të Bizneseve	70 74	ASN dhe studime nga informacione alternative
Administrata Publike, Shëndetësia & Arsimi	75; 80; 85	Ministria e Financave dhe Pasqyrat Financiare për shëndetësinë dhe arsimin privat
Shërbimet	90-99	Për aktivitetin 91 dhe 92 përdoret informacion nga Ministria e Financave lidhur me shpërndarjen e shpenzimeve sipas institucioneve. Për pjesën tjetër të shërbimeve në mungesë të informacionit përdoren struktura të aktiviteteve të krahasueshme dhe informacion nga ASN.

Për shpërndarjen e strukturës së kostos për sektorët që nuk mbulohen nga ASN përdoren burime të tjera ku mund të përmendim:

- Aktiviteti i Bujqësisë – Të dhënat për të gjitha inputet e përdorura në prodhimin bujqësor merren në nivel produkti nga Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në INSTAT. Duke u bazuar në natyrën e produktit është bërë kodifikimi dhe klasifikimi i tij në kodin përkatës CPA;
- Aktivitetet Financiare – Për aktivitetet financiare është përdorur informacioni i bilanceve të bankave të nivelit të dytë. Duke qenë se bankat e nivelit të dytë përbëjnë pjesën më të madhe të këtij aktiviteti struktura e nxjerrë përdoret për të gjitha aktivitetet financiare;
- Administrata Publike, Shëndetësia dhe Arsimi - Të dhënat merren nga Ministria e Financave për çdo institucion në nivel të detajuar mbi shpenzimet qeveritare të kryera për konsum ndërmjetës. Për secilën kategori të shpenzimeve është vendosur kodi përkatës në CPA për të mundësuar integrimin e këtij informacioni në TBP;

Gjithashtu ka edhe disa produkte për të cilët ka një informacion më të saktë mbi vlerat e tyre siç është konsumi i energjisë elektrike, apo shpenzimet financiare për të cilët është e mundur të përcaktohet më saktë pjesa që shkon në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, qeverisjen qëndrore e lokale ose në familje. Në këto situata trajtimi i tyre bëhet në mënyrë të pavarur në mënyrë që të ruhen vlerat totale të deklaruara nga bilanci energjetik i vendit apo nga të dhënat financiare nga Banka e Shqipërisë.

6.1.7. Konsumi i Familjeve

Shpenzimet e konsumit final të familjeve përfshijnë shpenzimet e kryera nga familjet për blerjen e shërbimeve dhe të mirave të konsumit. Këto shpenzime mund të grupohen në tre grupe të mëdha:

- blerja e të mirave dhe shërbimeve;
- të mirat dhe shërbimet e prodhuara nga ndërmarrjet në pronësi të familjeve që mbahen për autokonsum;
- shpërblimi në natyrë;

Vlerësimi primar i konsumit të familjeve në Drejtorinë e Llogarive Kombëtare kryhet nga Sektori i Llogarive të Sektorëve Institucional. Burimi i të dhënave për shpërndarjen e konsumit final të familjeve sipas produkteve është Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF) mbi të cilin bëhen një sërë analizash dhe plotësim informacioni nga burime të tjera alternative. Gjithashtu një vlerësim për konsumin e familjeve është bërë dhe me metodën e qarkullimit të mallrave e cila do të shpjegohet më poshtë.

Informacioni në sistemin e TBP-ve është sipas klasifikimit CPA dhe konsumi i familjeve mblidhet sipas nomenklaturës COICOP[1] e cila i grupon produktet sipas qëllimit të përdorimit dhe për këtë qëllim është e nevojshme të bëhet ndërlidhja ndërmjet këtyre të dyjave. Duke qenë se nuk ka një korrespondencë të plotë midis dy klasifikimeve të mësipërme, është punuar për ndërtimin e një matrice lidhëse nëpërmjet peshave në një nivel detajimi 6 dhe 4 shifror sipas CPA 2002.

[1] Classification of Individual Consumption According to Purpose

Vlerësimit që bëhet për këtë komponent në vlerësimin e PBB-së sipas metodës së shpenzimeve, i bashkëngjiten edhe vlerësimet dhe analizat që vijnë pas zbatimit të metodës së qarkullimit të mallrave.[1] Ideja bazë e kësaj metode është se sasia e një produkti për përdorim në një ekonomi duhet të furnizohet ose nga prodhimi vendas ose nga importet. E njëjta sasi produkti që hyn në ekonomi në një periudhë të caktuar kontabël duhet të përdoret për konsum të ndërmjetëm, për shpenzime të konsumit final, për formim kapitali (duke përfshirë ndryshimin në inventarë) ose eksporte. Ekuacioni përmbledhës i metodës është:

$$KF = \left(P + Im\right) - \left(Kn + Q + FBKF + Ni + Ek\right) \qquad \text{(ek.5)}$$

Ku:
C - Konsumi final i familjeve
P - Prodhimi,
Im - Importi,
Kn - Konsumi i ndërmjetëm,
Q - Konsumi i qeverisë dhe OJF-ve[2]
FBKF - Formimi bruto i kapitalit fiks,
Ni - Ndryshimi në inventar,
Ek - Eksporti.

Kjo analizë mundëson një vlerësim më të saktë të konsumit të familjeve sidomos për disa produkte për të cilët informacioni është shumë i vështirë për tu mbledhur me anë të anketave.

[1] Metoda "Commodity Flow"
[2] Organizatat jo fitimprurëse që ju shërbejnë familjeve

6.1.8. Eksporti

Eksportet janë një matricë vektoriale në tabelën e përdorimeve. Ashtu si për importet, të dhënat për eksportet merren nga sektori i tregtisë së jashtme për të mirat e eksportuara dhe nga Bilanci i Pagesave për pjesën e shërbimeve të eksportuara. Eksportet e të mirave dhe shërbimeve vlerësohen me çmime FOB. Integrimi i tyre në sistemin e TBP-ve mbështetet mbi të njëjtat klasifikime dhe nivel detajimi si në rastin e importeve. Pra për të mirat përdoret klasifikimi CN 8 shifrorë i cili më pas duke përdorur lidhjen CN-CPA kalon në nivele më të agreguara deri në nivelin 2 shifror që përdoret në sistemin e TBP-ve. Të dhënat për eksportin e shërbimeve merren nga Bilanci i Pagesave dhe më pas klasifikohen në nivel produkti.

6.1.9. Formimi i Kapitalit Fiks Bruto

Formimi i kapitalit Fiks Bruto (FKFB) në llogaritë kombëtare është i njëjtë me konceptin e investimeve të përdorura në kontabilitetin e ndërmarrjeve. Ky komponent përfshin mallra të prodhuara dhe importuara për formim kapitali si makineri, ndërtesa, rrugë, veprat origjinale, apo edhe përmirësime për aktivet jo-prodhuese. Informacioni primar për këtë tregues merret nga vlerësimet vjetore të PBB-së me metodën e shpenzimeve dhe më pas bëhen analiza në nivel produkti për të bërë një vlerësim më të plotë të tij. Niveli i detajimit të informacionit fillestar është për disa grupe kryesore siç paraqiten në tabelën 22.
Për secilin prej zërave në tabelë bëhen analiza më të detajuara për të shpërndarë secilin prej tyre në një nivel më të detajuar produkti. Komponenti kryesor është ndërtimi i cili është kryesisht i krijuar brenda vendit. Peshë të rëndësishme zënë makineritë dhe mjetet e transportit të cilat janë kryesisht produkte të importuara, kështu duke përdorur të dhënat e tregtisë së jashtme këto produkte shpërndahen në nivelin më të mirë të detajimit.

Tabela 22: Klasifikimi i FKFB

Përshkrimi
1. Bujqësia
1.1. Blegtoria
1.2. Pemëtaria
1.3. Pyjet
2. Kërkime Minerare
3. Ndërtimi
3.1. Ndërtesa për banim
3.2. Ndërtesa jo për banim
3.3. Ndërtime inxhinierike
4. Makineri dhe pajisje
5. Mjete transporti
6. Programe kompjuterike dhe databaza

Nëpërmjet korrespondencave ekzistuese midis klasifikimit CN dhe BEC mundësohet njohja e qëllimit final të importit të të mirave. Sipas klasifikimit BEC (shiko tabelën 23) produktet e importuara ndahen në 4 grupe kryesore sipas qëllimit final. Duke përdorur tipin tre të klasifikimit BEC, mund të gjejmë importin e të mirave për qëllim formim kapitali, në një nivel detajimi CN 8 shifrorë të cilat agregohen më pas në nivel CPA 2 shifrorë. Në disa raste është e rëndësishme që të bëhen edhe studime në nivel produkti për të përcaktuar më saktë qëllimin e përdorimit të tij. Kjo vjen për faktin se disa produkte mund të kenë më shumë se një qëllim përdorimi dhe në këtë rast është e rëndësishme të përcaktohen edhe peshat sipas kategorive ku vete produkti.

Tabela 23: Kategoritë e të mirave të importuara sipas nomenklaturës BEC

Bec	Bec_tipi	Bec_përshkrimi
111	2	Konsum i Ndërmjetëm (+taksa)
112	1	Të mira për Konsum (+taksa)
121	2	Konsum i Ndërmjetëm (+taksa)
122	1	Të mira për Konsum (+taksa)
210	2	Konsum i Ndërmjetëm (+taksa)
220	2	Konsum i Ndërmjetëm (+taksa)
310	2	Konsum i Ndërmjetëm (+taksa)
321	4	Të pa klasifikuara
322	2	Konsum i Ndërmjetëm (+taksa)
410	3	Kapital
420	2	Konsum i Ndërmjetëm (+taksa)
510	4	Të pa klasifikuara
521	3	Kapital
522	1	Të mira për Konsum (+taksa)
530	2	Konsum i Ndërmjetëm (+taksa)
610	1	Të mira për Konsum (+taksa)
620	1	Të mira për Konsum (+taksa)
630	1	Të mira për Konsum (+taksa)
700	4	Të pa klasifikuara

Makineritë dhe pajisjet shpërndahen sipas kësaj strukture dhe i shtohen pjesës tjetër të formimit bruto të kapitalit fiks. Edhe për grupin e produkteve që janë të paklasifikuara nga BEC, është punuar duke studiuar secilin prej produkteve dhe aktivitetin e importuesit për të shpërndarë vlerën e importuar në një nga tre kategoritë kryesore. Ky studim mundëson një shpërndarje të plotë të produkteve të importuara sipas kategorive.

Vlerësimi total i FKFB bëhet duke inkorporuar të gjitha të dhënat nga burime të ndryshme si ASN, bilancet e ndërmarrjeve, të dhënat nga sektori bujqësisë dhe të dhënat e tregtisë së jashtme.

6.1.10. Shpenzimet e konsumit final të qeverisë dhe OJF-ve

Shpenzimet e konsumi final të qeverisë përfshijnë të gjitha shpenzimet përfundimtare për mallra dhe shërbime të kryera nga të gjitha institucionet e përfshira në sektorin e qeverisë. Shpenzimet e konsumit final të qeverisë përbëhen nga shpenzime për qëllime kolektive dhe shpenzime për qëllime individuale. Shpenzimet qeveritare për qëllime kolektive përfshijnë shpenzimet e administratës publike, mbrojtjes, sigurisë, përmirësime në mjeksinë e përgjithshme, etj. Shpenzimet qeveritare për qëllime individuale përfshijnë shëndetësinë dhe arsimin, kontributin në të mira për ushqime, etj.

Të njëjtat koncepte që përdoren për institucionet qeveritare përdoren edhe për OJF-të, kjo për faktin se edhe këto institucione kanë prodhim jo-tregtar. Duke qenë se OJF-të janë në shërbim të familjeve, shpenzimet e tyre janë të përfshira vetëm në shpenzime individuale. Për të bërë integrimin e këtij treguesi në sistemin e TBP-ve përdoret informacioni i detajuar që merret nga Ministria e Financave në nivel institucioni të cilat klasifikohen sipas CPA 2 shifrore nisur nga qëllimi i shpenzimit të kryer.

6.1.11. Ndryshimi në inventar

Në sistemin e TBP-ve një nga komponentët përbërës nga krahu i përdorimeve janë edhe ndryshimet e gjendjeve. Ky është një nga komponentët më të vështirë për tu trajtuar në nivel produkti kur informacioni i mbledhur është në nivel të agreguar. Në sistemin e TBP-ve ndryshimi i gjendjeve duhet bërë për çdo produkt më vete, i cili kërkon që dhe informacioni të jetë në këtë formë. Në rastin e Shqipërisë ky informacion nuk është në dispozicion në nivel produkti dhe për këtë arsye përdoret një metodë alternative për të bërë të mundur këtë vlerësim. Problemi primar ekziston në vlerësimin e vlerës totale të ndryshimit të gjendjeve në ekonomi. Për të bërë këtë vlerësim janë përdorur të dhënat e marra nga ASN dhe Pasqyrat Financiare të ndërmarrjeve.

Për të vlerësuar vlerën totale për një vit të caktuar (viti t) merret informacion edhe nga viti paraardhës (t-1) dhe viti pasardhës (t+1) në mënyrë që të përmirësohet informacioni i përdorur në nivel ndërmarrje. Për secilën nga ndërmarrjet merret vlera e materialeve në fillim të periudhës (t), e cila kontrollohet me vlerën e raportuar për fundin e periudhës së vitit të mëparshëm, dhe vlera në fund të periudhës (t) e cila kontrollohet me vlerën e raportuar në fillim të periudhës pasardhëse. Informacioni grupohet si në tabelën 24.

Tabela 24: Klasifikimi i ndryshimit të gjendjeve

	Gjendja në fillim						Gjendja në fund					
	Lëndë e parë	Puna në proces	Produkte të gatshme	Mallra për rishitje	Parapagesa për furnizime	Totali	Lëndë e parë	Puna në proces	Produkte të gatshme	Mallra për rishitje	Parapagesa për furnizime	Totali
NVE 2 shifrore												

Vlerësimi i vlerës totale për kategoritë e ndryshme të ndryshimit të gjendjeve bëhet vetëm në rastin kur kemi pasur informacion në të dy vitet (paraardhës dhe pasardhës). Në vlerësimin e ndryshimit të gjendjeve janë përfshirë katër kategoritë e inventarit (lëndë e parë, prodhim në proces, produkte të gatshme dhe mallra për rishitje), ndërsa kategoria parapagesa për furnizime nuk është përfshirë pasi nuk lidhet me ndryshimin e gjendjeve fizike të produktit. Burimi primar është mbështetur mbi Pasqyrat Financiare dhe për ndërmarrjet që nuk kanë plotësuar Pasqyrat Financiare është analizuar informacioni që vjen në ASN. Informacioni ekzistues si në pasqyrat financiare ashtu edhe në ASN lidhur me ndryshimin e gjendjeve merret si në tabelën më poshtë.

Tabela 25: Inventari

	Inventari	Viti ushtrimor t	
		Gjendja në Fillim	Gjendja në Fund
1	Lëndë e parë		
2	Prodhim në proces		
3	Produkte të gatshme		
4	Mallra për rishitje		
5	Parapagesat për furnizime		
6	Total		

Është shumë e rëndësishme që të theksojmë faktin se përveç informacionit në tabelë ekziston edhe një informacion që përdoret për të testuar nëse ndërmarrja ka pasur ndryshim gjendje apo jo i cili ndodhet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve (PASH) dhe konsiston në:

- Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshëm e prodhimeve në proces (+/-) i cili korrespondon me shumën e zërave 2 dhe 3 te tabela e inventarit.
- Ndryshimet e gjendjeve të materialeve i cili duhet që të jetë i barabartë me lëndë të para plus prodhim në proces nga tabela e inventarit.
- Ndryshimet e gjendjeve të mallrave (+/-) i cili duhet që të jetë i barabartë me produkte të gatshme plus mallra për rishitje nga tabela e inventarit.

Edhe në këtë rast si edhe te ASN, informacioni që merret nga PASH i pasqyrave financiare të firmës mund të përdoret si krahasim apo edhe për qëllime analizimi apo inputimi. Dallimi i vetëm është se te PASH i pasqyrave financiare përcaktimi i ndryshimit jo gjithmonë mund të jetë shumë mirë i specifikuar. Pra mund të hasen raste kur përfshihet në një zë më vete vetëm ndryshimi i ndryshimit të inventarëve të produkteve të gatshme por mund të ketë raste kur përfshihet edhe puna në proces. Në këto raste bëhet një analizë e detajuar e informacionit që ndërmarrja raporton për të përcaktuar sa më mirë natyrën e ndryshimit të gjendjeve.

Për vlerësimin e ndryshim gjendjeve përveç vlerësimit në terma absolut të vlerës së tyre është e rëndësishme të kryhet edhe axhustimi i vlerave me çmimet përkatëse. Kjo është e nevojshme pasi ndryshim gjendjet janë si diferencë e vlerave të dy periudhave të skajshme në vlerësim të cilat nuk janë me të njëjtin nivel çmimi të vlerësuar. Për këtë qëllim përdoren një sërë metodash ku mund të përmendim:

- Hyrja e fundit - dalja e parë (LIFO): Kostoja e artikujve të shitur apo konsumuar gjatë një periudhe llogaritet me çmime sikur ata të ishin shitur apo konsumuar në momentin e blerjes së tyre;
- Metoda mesatare: Kostoja e një artikulli përcaktohet duke aplikuar një mesatare të ponderuar të kostos së të gjitha mallrave të cilat janë në dispozicion për shitje gjatë një periudhe kohore;
- Hyrja e parë - dalja e parë (FIFO): Kostoja e artikujve të shitur apo konsumuar gjatë një periudhe llogaritet me çmime sikur ata të ishin shitur apo konsumuar në momentin e blerjes së tyre më të fundit;

Në rastin e Shqipërisë përdoret metoda mesatare ku për çdo kategori të ndryshimit të gjendjeve merren indekset përkatëse të çmimeve.
Siç e përmendëm edhe në fillim një nga problemet kryesorë është fakti se ndryshimin e gjendjeve nuk e kemi sipas produkteve, e cila e vështirëson shumë punën për përfshirjen e tyre në sistemin e TBP-ve. Për këtë qëllim përdoret një metodë indirekte duke përdorur disa supozime bazë. Pasi bëhet vlerësimi për të gjithë ekonominë për komponentët përkatës të tabelës së inventarit, për ti shpërndarë sipas produkteve përdoren këto alternativa për çdo kategori të inventarit:

- Pjesa e totalit të lëndës së parë që pasqyrohet në degët e shërbimeve tek vlerësimi i inventarit (sipas metodës mesatare), shpërndahet me strukturën totale të konsumit ndërmjetës. Kurse pjesa e lëndës së parë që shkon tek degët e industrive (pjesa e të mirave) shpërndahet me strukturën e kostos së degës përkatëse nga konsumi ndërmjetës.
- Për shpërndarjen e zërit prodhim në proces në nivel produkti përdoret struktura e prodhimit nga lista e produkteve ku merren vetëm ato ndërmarrje që kanë pasur prodhim në proces në tabelën e inventarit dhe kanë plotësuar listën e produkteve.
- Për produktet e gatshme si strukturë është përdorur ajo e prodhimit.
- Mallrat për rishitje duke qenë se janë mallra tregtarë, janë shpërndarë me strukturën totale të marzhit të tregtisë.

Këto supozime janë mbështetur mbi një sërë analizash që janë bërë mbi natyrën që ka çdo kategori e ndryshim gjendjeve duke mundësuar një përafrim më të mirë të tyre me produktet të cilave ato i përkasin. Gjithashtu për disa produkte të cilat kanë një natyrë më të thjeshtë, pra ato që kanë destinacion vetëm eksportin. Janë bërë kontrolle edhe me të dhënat e tregtisë së jashtme për të krahasuar vlerësimet e arritura me shpërndarje strukturore me ato reale për këto produkte.

6.2. Procesi balancues

Procesi balancues është një proces shumë i rëndësishëm në tabelat e burimeve dhe përdorimeve. Pasi është bërë një përpunim i detajuar për secilin produkt, duhet që gjithë burimet e një vendi të shkojnë si përdorime nga ana tjetër. Në shumicën e rasteve kjo mund të mos arrihet që në hapin e parë të përdorimit të informacionit, për këtë qëllim analiza zhvillohet mbi çdo produkt në këtë sistem.

Përpara se të shikohet mospërputhja në nivel produkti analizohet mospërputhja statistikore që ekziston ndërmjet metodave të ndryshme të vlerësimit të PBB-së. Në sistemin e tabelave të burim përdorimeve kjo mospërputhje statistikore eliminohet e si rrjedhim kërkohet që të arrihet ky balancim makroekonomik. Për këtë qëllim mbështetur mbi informacionin e detajuar të ndërtuar për çdo produkt shikohen mundësitë e domosdoshme për ndryshim të vlerave absolute për një nga treguesit të metodës së prodhimit ose të shpenzimeve. Vetëm pasi është arritur një balancim në nivel makroekonomik i vlerave absolute të metodave të ndryshme të PBB-ve kalohet në analizën e mospërputhjeve për çdo produkt midis burimeve dhe përdorimeve.

Në rastet kur diferenca ndërmjet burimeve dhe përdorimeve është më e vogël se 5 % përdoret një balancim automatik i mbështetur mbi shpërndarjen në formë raporti të diferencës ekzistuese. Kur kjo diferencë është ndërmjet 5 % dhe 10 % mund të mbështetemi mbi një analizë dhe balancim manual të diferencave. Në rastet kur kjo diferencë është më e madhe se 10 % atëherë jemi në një situatë e cila kërkon trajtim në burimin bazë të informacionit.

Në këto raste shikohen të gjitha të dhënat nga kanë ardhur vlerësimet për të kuptuar fenomenin që ka ndodhur dhe për të përcaktuar sa më saktë arsyen e diferencave. Në këto raste mund të jetë e nevojshme që komponent të ndryshëm të burimeve apo përdorimeve të kërkojnë një rivlerësim i cili do të sillte një cikël rrethor të vlerësimeve. Ky cikël do të vazhdojë derisa të gjitha diferencat të jenë brenda intervaleve të pranueshme duke na mundësuar një konsistencë të plotë të vlerësimeve të PBB-së me metoda të ndryshme.

6.3. Tabelat e Burimeve dhe Përdorimeve me çmime konstante

Sistemi i TBP-ve është i rëndësishëm që të ndërtohet me çmime korente dhe konstante për një vend. Ndërtimi i tyre me çmime konstante mundëson që të kemi një vlerësim të vetëm të rritjes ekonomike pavarësisht metodës që është përdorur. Duke qenë se TBP-të në shumë raste janë në nivel të detajuar produkti mundësojnë aplikimin e indekseve specifike të çmimeve sipas produkteve duke qenë më pranë analizës homogjene të çmimit dhe produktit. Për ndërtimin e këtyre tabelave duhet që TBP-të me çmime korente të vlerësohen dhe të balancohen për dy vite të njëpasnjëshëm. Këto tabela ndërtohen mbi parimin e thjeshtë që ndryshimi i vlerës së një produkti homogjen vjen si shkak i ndryshimit të volumit ose të çmimit. Nisur nga ky parim tabelat përfundimtare duhet të jenë një sistem i balancuar me çmime konstante ku ndryshimet në të gjithë komponentët përbërës të tyre vijnë pikërisht për shkak të një ndryshimi real në volum ose ndryshimit të çmimit të produktit përkatës.

Baza metodologjike për vlerësimin e TBP-ve me çmime konstante është mbështetur mbi standardet evropiane. Siç rekomandohet ne manualin e Eurostat për vlerësimin e çmimeve dhe volumit për LLK për secilin komponent[1] janë marrë indekse specifike të cilët janë në nivelin më të detajuar të mundshëm. Indekset më të përdorur janë:

Indeksi i Çmimit të Prodhimit (IÇP),
- Indeksi i Çmimit të Konsumit (IÇK),
- Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (IKN)
- Indeksi i Vlerës Njësi (UVI)
- Indeksi i pagës mesatare
- Indekset e produkteve bujqësore dhe të peshkimit

Këto indekse janë përdorur në nivel produkti për të deflatuar secilin komponent të TBP-ve në nivel të pavarur.

Indeksi i Çmimit të Prodhimit (IÇP) - mat nivelin e ndryshimit në çmimin e prodhimit të të mirave të prodhuara në Shqipëri dhe të shitura nga prodhuesit në tregun e brendshëm dhe/ose të jashtëm. Çmimet e prodhimit të mallrave industriale mblidhen sipas CPA 6 shifror dhe përbëhen nga dy nën-indekse:
- IÇP në tregun e brendshëm i cili mat nivelin e ndryshimit te çmimit te prodhimit të mallrave industriale të prodhuara dhe shitur nga prodhuesit në tregun e brendshëm;
- IÇP në tregun e jashtëm i cili mat nivelin e ndryshimit të çmimit të prodhimit të mallrave industriale shitur nga prodhuesit në tregun e jashtëm;

Indeksi i çmimit të prodhimit është një kombinim i indeksit të çmimit të prodhimit në tregun e brendshëm dhe indeksit të çmimit të prodhimit në tregun e jashtëm. Burimi kryesor i të dhënave është ASN dhe peshat janë të ndryshueshme çdo vit.

[1] Shih "Handbook on priceand volume measures in National Accounts" në Referencat

IÇP në sistemin e TBP-ve gjen përdorim në shumë prej produkteve dhe komponentëve të saj. Ky indeks sipas detajimit që është përdorur analiza mbi produktin mund të përdoret në nivelin e detajimit 6 shifrorë. Në këtë situatë korrespondenca e produktit me çmimin është mjaftë e lartë duke siguruar në këtë mënyrë një cilësi mjaft të mirë. Në mungesë të këtij detajimi përdoret një nivel më i agreguar i tij si në nivelet 4 ose 2 shifrore i grupit ku produkti bënë pjesë. Gjithashtu specifikimet në deflatim bëhen edhe mbi bazën e komponentit përkatës. Kështu për deflatimin e produkteve të prodhuara duke qenë se ato janë të gjitha të prodhuara brenda vendit dhe janë me çmime bazë përdoret IÇP e tregut të brendshëm. Ndërsa për të deflatuar eksportet në këtë rast përdoret po e njëjta IÇP por për tregun e jashtëm. Në këtë mënyrë konsistenca mes çmimit dhe produktit rritet ndjeshëm.

Përsa i përket komponentëve të tabelës së përdorimeve ku ata janë të vlerësuar me çmime tregu, matrica e konsumit ndërmjetës është ndarë në konsum ndërmjetës të importuar dhe të brendshëm. Për pjesën e importuar është përdorur UVI (në mungesë të IÇP-së për të mirat e importuara) në nivel produkti (CPA 6 shifrore) ndërsa për pjesën e brendshme është përdorur IÇP për tregun e brendshëm.

Indeksi i Çmimit të Konsumit (IÇK) - mat ndryshimin e çmimit të një shporte fikse produktesh dhe shërbimesh nga periudha bazë në periudhën korente. Si klasifikim për IÇK-në është përdorur klasifikimi ndërkombëtar i të mirave dhe shërbimeve të konsumatorit, COICOP. Ky indeks përdoret sidomos për të deflatuar konsumin e familjeve dhe niveli i punimit bëhet në nivelin më të detajuar të COICOP. IÇK përdoret edhe për produktet e grupit të shërbimeve si nga krahu i prodhimit ashtu edhe përdorimit pasi nuk ka një indeks prodhimi për shërbimet në Shqipëri.

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (IKN) - mat ecurinë e çmimeve të materialeve të ndërtimit, të fuqisë punëtore dhe të shpenzimeve të tjera kapitale që përdoren në ndërtimin e një banese tip. Shpenzimet janë klasifikuar në përputhje me klasifikimin që përdor EUROSTAT për Indeksin e Kushtimit në Ndërtim, në gjashtë grupe kryesore si më poshtë:

- Shpenzime për materiale;
- Shpenzime për paga;
- Shpenzime për makineri;
- Shpenzime transporti;
- Shpenzime për energji;
- Shpenzime të tjera;

IKN në sistemin e TBP-ve përdoret për të deflatuar produktet e ndërtimit si nga krahu i prodhimit edhe i përdorimit.

Indeksi i vlerës njësi (UVI) - është një indeks që mat ndryshimin e kostos mesatare të të mirave. Nuk është një indeks çmimi duke qenë se ndryshimet mund të vijnë si pasojë e ndryshimeve në çmim dhe sasi. UVI është përdorur për deflatimin e importit të të mirave duke qenë se nuk ka akoma një vlerësim të indeksit të çmimeve të importit i cili mat ndryshimin në kohë të çmimit të të mirave dhe shërbimeve të importuara por është shumë e rëndësishme të mbulojë një nivel të detajuar produktesh.

Shumë vende përdorin një metodë mikse për deflatimin e importeve, që do të thotë kombinim i UVI-t me indeksin e çmimeve të importit, sidomos për të mirat heterogjene ose që ndikohen nga efekte sezonale. UVI vlerësohet në nivel 8 shifrorë të nomenklaturës CN në nivel produkti dhe mbështetet mbi të dhënat e importit. Nga të dhënat e importeve janë marrë këto informacione bazë të cilat janë përdorur më pas për vlerësimin e tij:

- data e importit;
- numri identifikues i importuesit;
- kodi i klasifikimit CN 8-shifrorë;
- njësia suplementare dhe pesha neto;
- vlera e importit (CIF);
- taksat doganore, akciza dhe TVSH;

Duke qenë se Shqipëria është një vend i vogël, numri i transaksioneve nuk është shumë i lartë, për këtë arsye nuk janë marrë në konsideratë vendi i origjinës apo lloji i transaksionit. Vlerësimi i UVI-t ka kaluar në disa hapa kryesor. Së pari duke qenë se ka probleme në plotësimin e njësive suplementare janë marrë të dyja në studim për t'i krahasuar (njësia dhe pesha). Për një produkt të vitit t është përdorur ajo njësi që është plotësuar më shumë sipas transaksioneve. Për të qenë të krahasueshme edhe në vitin t-1 është përdorur e njëjta njësi si në vitin t.

Hapi i dytë i metodës është eleminimi i vlerave të largëta. Janë marrë në studim vetëm produktet me numër transaksionesh ≥30 (përafrimi me shpërndarjen normale), mbi të cilët janë eliminuar vlerat e largëta. Pesha e produkteve të marra në studim pas aplikimit të metodës është rreth 85 % e totalit të importit të të mirave. E njëjta metodë aplikohet edhe për vitin paraardhës por vetëm për produktet që lidhen me vitin aktual, duke krijuar konsistencë midis dy viteve.

Në hapin e tretë krijohet indeksi i vlerës për të dy vitet, për listën e produkteve të lidhura. Pra në trajtë ekuacioni mund të paraqitej si më poshtë:

$$UV^{t}_{CN8_i} = \frac{V^{t}_{CN8_i}}{u^{t}_{CN8_i}} \quad \text{dhe} \quad UV^{t-1}_{CN8_i} = \frac{V^{t-1}_{CN8_i}}{u^{t-1}_{CN8_i}} \qquad (ek.6)$$

Ku:

$i \in \{1, 2, \ldots\ldots\ldots\ldots\ldots, n\}$

t ® viti

v ® vlera

u ® njësia

Pas këtij kontrolli vendoset se cila njësi do të përdoret midis peshës neto dhe njësisë suplementare. Më pas nëpërmjet formulës më poshtë krijohet indeksi UVI për çdo produkt:

$$UVI_{t/t-1} = UV^{t}_{CN8_i} \Big/ UV^{t-1}_{CN8_i} \qquad (ek.7)$$

Për deflatimin e produkteve të përjashtuar nga studimi, duke qenë se kanë një peshë relativisht të ulët, është përdorur UVI total i vlerësuar sipas metodës më sipër. Metoda ka avantazhin e ndryshimit të vitit bazë çdo vit duke bërë që lista e produkteve të jetë më përfaqësuese për periudhën aktuale.

Indekset e çmimeve të produkteve bujqësore - Për vlerësimin e produkteve bujqësore dhe peshkimit me çmime konstante përdoren indekse çmimi të marra nga sektori përkatës. Në përgjithësi për çdo produkt në bujqësi dhe për çdo vit janë të disponueshme të dhënat e prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm në sasi dhe çmime. Vlerësimet për prodhimin dhe konsumin e ndërmjetëm me çmimet e vitit të mëparshëm arrihen duke shumëzuar sasinë në periudhën t me çmimet e periudhës t-1. Ky vlerësim bëhet në nivel produkti duke mundësuar një konsistencë të plotë të çmimeve me produktet.

Indeksi i pagave për aktivitetet jo-tregtare - Për aktivitetet jo-tregtare siç janë administrata publike, arsimi dhe shëndetësia, janë përdorur indekset përkatëse të pagave mesatare, duke reflektuar zhvillimin e çmimit të punës, i cili është faktori kryesor i prodhimit për këta sektor. Për aktivitetin e arsimit dhe shëndetësisë bëhet një ndarje e prodhimit jo-tregtar dhe atij tregtar duke bërë të mundur në këtë mënyrë dhe përdorimin e indekseve specifike për secilin rast.

Vlerësimi i taksave në terma volumi - Disa nga komponentët e TBP-ve nuk mund të deflatohen me një indeks specifik çmimi. Një situatë e tillë është për taksat dhe subvencionet mbi produktet. Ato lidhen direkt me sasinë ose vlerën e një të mire apo shërbimi që është subjekt i një transaksioni të caktuar. Të ardhurat nga taksat sipas grupeve të caktuara do të varen nga sasia e produkteve të përfshira në transaksion, çmimet e produkteve dhe norma e taksës si përqindje. Pra vlerësimi i taksave në terma volumi mund të arrihet duke shumëzuar raportin e tyre ndaj produktit të cilës ato i përkasin për periudhën t-1 dhe duke e shumëzuar me vlerën e produktit në terma volumi për periudhën t. Në trajtë matematikore mund të shprehej:

$$T^{t}_{i_{kons}} = \frac{T^{t-1}_{i_{kore}}}{P^{t-1}_{i_{kore}}} \cdot P^{t}_{i_{kons}} \qquad (ek.8)$$

Ku:

$T^{t}_{i_{kons}}$ → taksa në konstante për produktin i në vitin t

$P^{t}_{i_{kons}}$ → produkti i në konstante për vitin t

$T^{t-1}_{i_{kore}}$ → taksa në korente për produktin i në vitin t-1

$P^{t-1}_{i_{kore}}$ → produkti i në korente për vitin t-1

Duke qenë se kemi disa taksa mbi produktet kjo metodë aplikohet me vlerat përkatëse të produkteve mbi të cilat ajo aplikohet. Kështu për shembull në rastin e TVSH-së kjo normë aplikohet mbi vlerën e shpenzimeve të familjeve pasi konsumatorët janë ata që mbartin totalin e TVSH-së në fund. Për taksat e importeve aplikohen vlerat respektive të të mirave të importuara e kështu me radhë për të gjitha kategoritë. Çdo ndryshim i normës së taksës në vitin aktual do të reflektonte një ndryshim në çmim dhe jo në volum.

Kategoria e dytë, taksa mbi produktet e prodhuara në vend është vlerësuar në terma volumi duke aplikuar normën e rritjes së produktit në vitin aktual ndaj taksave të vitit të mëparshëm në nivel CPA 2 shifrore. Kjo vjen për shkak të nivelit të ulët të detajimit të taksave mbi produktet e prodhuara në vend. Metoda do të përmirësohet duke aplikuar normën e rritjes së PBB-së sipas degëve të klasifikimit NVE.

Vlerësimi i marzheve të tregtisë dhe transportit në terma volumi - Logjika që përdoret për të deflatuar taksat në terma volumi përdoret edhe për vlerësimin e marzheve të tregtisë dhe transportit. Duke qenë se këto marzhe janë ndaj totalit të burimeve pra prodhimit dhe importeve atëherë metoda e përmendur më sipër për rastin e taksave aplikohet mbi shumën e këtyre vlerave. Pra raporti i marzheve ndaj totalit të prodhimit dhe importeve të periudhës t-1 shumëzohet me vlerën totale të prodhimit dhe importeve me çmime konstante të periudhës t.

Pasi bëhet vlerësimi i të gjithë komponentëve përkatës të TBP-ve në çmime konstante hapi tjetër ka të bëjë me procesin e balancimit. Duke qenë se TBP-të me çmime konstante janë të mbështetura mbi TBP-të e balancuara me çmime korente pritet që tabelat e reja të mos kenë diferenca të mëdha në nivel produkti. Në rast të prezencës së këtyre diferencave është e rëndësishme që të kontrollohen indekset e çmimeve të përdorura për një specifikim më të mirë të tyre.

7. Tabelat input-output

Tabelat e burimeve dhe përdorimeve janë pjesa kyçe e sistemit të llogarive kombëtare dhe përdorimi kryesor i tyre është balancimi i llogarive kombëtare. Gjithashtu ato strukturojnë bazën e të dhënave nga e cila derivohen të dhënat e nevojshme për ndërtimin e modeleve makroekonomike dhe analiza e impaktit të tyre në formën e tabelave simetrike të input-outputit (TIO). Në thelb TBP-të janë drejtkëndore, pra numri i produkteve nuk duhet të jetë patjetër i barabartë me numrin e industrive. Në praktikë është e rëndësishme një nivel i lartë detajimi në produkte, pra numri i produkteve të jetë më i lartë se i industrive.

Konvertimi i TBP-ve në TIO konsiston në heqjen e prodhimit sekondar nga matrica e prodhimit dhe të inputeve respektive nga matrica e konsumit ndërmjetës. Kalimi nga TBP në tabelat simetrike të TIO kërkon një grup nën-tabelash të TBP-ve me çmime blerësi dhe matricat e vlerësimit për tu konvertuar në tabela burim-përdorimi me çmime bazë duke paraqitur veç importet dhe prodhimin e brendshëm. Tabelat e burim-përdorimit me çmime bazë përbëjnë bazën e të dhënave të nevojshme për ndërtimin e tabelave input-output. Në sistemin e burim-përdorimit importet paraqiten në tabelën e burimeve të klasifikuara sipas produkteve, por jo të ndara sipas përdorimeve në tabelën e përdorimeve. Në këtë llogaritje, nuk kërkohet informacion në lidhje me origjinën e produktit të përdorur nga secila kategori e kërkesës. Në shumë analiza kërkesa finale për prodhim nga prodhuesit vendas dhe nga importi duhet të vlerësohet e ndarë.

7.1. Baza e të dhënave për transformimin

Baza e të dhënave të nevojshme për transformimin TBP-ve në tabelela TIO përmban tabelat në vazhdim

- Tabela e burimeve me çmime bazë
- Tabela e përdorimeve me çmime bazë
- Tabela e përdorimeve për prodhimin e brendshëm me çmime bazë
- Tabela e përdorimit të importeve me çmime bazë

Në sistemin e burimeve me çmime bazë, kolonat për marzhin e tregtisë dhe të transportit dhe taksat neto bëhen të parëndësishme, megjithatë taksa jo të zbritshme minus subvencionet krijojnë një rresht në tabelën e përdorimeve, meqë përdorimet totale vazhdojnë të vlerësohen në çmime blerësi.

Në vijim do të shpjegohen të detajuara katër modelet bazë të ndërtimit të tabelave simetrike të input-outputit. Aty përfshihen dy modelet që bazohen në supozimin e teknologjisë të cilat gjenerojnë tabelat input-output produkt -produkt. Në këtë rast tabelat e input-outputit përbëhen nga produkte homogjene në rreshta dhe njësi homogjene prodhimi (degë) në kolona.

Dy modelet e tjera bazohen në supozimin e një strukture shitjesh fikse dhe gjenerojnë tabelat e input-outputit industri-industri. Rezultat janë tabelat e input-output me industri në rreshta dhe industri në kolona. Në terminologji këto dy prototipe të tabelave simetrike të input-outputit quhen tabela input-output produkt-produkt dhe industri-industri.

Katër modelet standarte që mund të përdoren për ndërtimin e tabelave input-output sipas kategorizimit produkt për produkt apo industri-ndustri bazohen në supozimet e më poshtme:

a. Supozimi i teknologjisë së produktit (Modeli A). Secili prej produkteve prodhohet në mënyrën e vetë specifike, pavarësisht nga industria në të cilën prodhohet. Pra teknologjia që përdoret për të prodhuar një produkt specifik është e njëjtë në të gjitha aktivitetet ekonomike.
b. Supozimi i teknologjisë së industrisë (Modeli B). Secila industri ka mënyrën e vetë të prodhimit, pavarësisht nga produkti miks. Në këtë rast aktiviteti ekonomik nuk ndryshon strukturë pavarësisht produktit që po prodhon.
c. Supozimi i strukturës së shitjeve fikse për industrinë (Model C). Secila industri ka strukturën e vetë të shitjeve, pavarësish nga produkti miks.
d. Supozimi i strukturës së shitjeve fikse për produktin (Model D). Secili produkt ka strukturën e vetë të shitjeve, pavarësisht nga industria në të cilën prodhohet.

Gjithashtu përveç modeleve bazë janë edhe dy modele të tjera transformimi:

a. Supozimi i teknologjisë hibride. Supozimi i teknologjisë hibride kombinon Modelin A dhe Modelin B për të shmangur vlerat negative në tabelat input-output produkt-produkt.
b. Procedura Almon. Procedura Almon është një algoritëm matematik i dizenjuar për të ndërtuar tabelat input-output, produkt-produkt të cilat bazohen në Modelin A, por nëpërmjet procedurës hap pas hapi eliminon të gjitha vlerat negative në tabelat input-output.

Tabelat input-output dhe burim-përdorimit shërbejnë për dy qëllime kryesore: statistikore dhe analitike. Ato ofrojnë një sistem kontrolli për konsistencën e statistikave mbi rrjedhën e të mirave dhe shërbimeve që nxirren nga burime të ndryshme statistikore. Sistemi i tabelave burim-përdorim shërben si një koordinator për statistikat ekonomike për përkufizimet e përdorura, për klasifikimet dhe për konsistencën numerike të të dhënave të marra nga burime të ndryshme.
Sistemi i input-output është i përshtatshëm për llogaritjen e të dhënave ekonomike të përfshira në llogaritë kombëtare dhe dallojnë dobësitë e të dhënave. Në veçanti, kjo është e rëndësishme për matjet e çmimeve dhe të volumit.

Si një mjet analitik, të dhënat e input-output janë integruar në modele makroekonomike për analizimin e lidhjes midis kërkesës finale dhe niveleve të prodhimit të industrive. Analiza input-output shërben edhe për qëllime të tjera analitike si psh. analiza e impaktit, efektet e punësimit, analiza e strukturave të ndërsjellta dhe analiza e ndryshimit të çmimeve. Një tabelë produkt-produkt TIO përshkruan lidhjet teknologjike midis produkteve dhe njësive homogjene të prodhimit (degëve). Pjesa e konsumit ndërmjetës cilëson për çdo produkt shumën e produkteve që janë përdorur për të prodhuar këtë produkt, pavarësisht industrisë ku është prodhuar.

Tabela 26: Tabela Input-Output me çmime bazë (produkt-produkt)

DEGË HOMOGJENE / Produkte (CPA)		DEGË HOMOGJENE								PËRDORIMET FINALE							Totali i Përdorimeve me çmime tregu
		Bujqësia, peshkimi gjuetia dhe silvikultura	Industria	Ndërtimi	Tregtia, hotele dhe restorante	Transporti, posta dhe komunikacioni	Shërbime të tjera	Totali		Konsumi i Familjeve	Ke Jo - Fitimprurëse	Konsumi i Qeverisë	Formimi i Kapitali Fiks Bruto	Ndryshim Gjendje	Eksportet	Totali	
Nr.		1	2	3	4	5	6	7		8	9	10	11	12	14	16	17
1	Bujqësia, peshkimi gjuetia dhe silvikultura	Matrica e konsumit ndërmjetës me çmime bazë								Kërkesa finale me çmime bazë							
2	Industria																
3	Ndërtimi																
4	Tregtia, hotele dhe restorante																
5	Transporti, posta dhe komunikacioni																
6	Shërbime të tjera																
7	Totali me çmime bazë																
8	Blerjet direkt të rezidentëve jashtë																
9	Blerjet direkt të jo-rezidentëve në tregun vendas																
10	Taksat minus subvencionet mbi produktet																
11	Totali me çmime tregu																
12	Kompensimi i punonjësve	Vlera e shtuar me çmime bazë															
13	Taksat neto mbi prodhimin																
14	Amortizimi i kapitalit fiks																
15	Surplusi operativ neto																
16	Vlera e shtuar me çmime bazë																
17	Prodhimi me çmime bazë																
18	Importe CIF																
19	Oferta me çmime bazë																

Pjesa e përdorimeve finale tregon përdorimet e produkteve në ekonomi pa e diferencuar nëse janë produkte të prodhuara në vend apo të importuara. Po ashtu në kuadratin më poshtë paraqitet edhe komponentët e vlerës së shtuar të cilët janë shpërndarë sipas produkteve të prodhuar nga të cilët është gjeneruar edhe vlera e shtuar. Duke shtuar dhe importet e secilit produkt në reshta poshtë prodhimit përftojmë totalin e burimeve për secilin produkt.

7.2. Llogaritja e tabelave simetrike input-output

Sistemi TBP-ve aktual është ndërtuar nga të dhënat e industrive pra sipas modelit 'lartë-poshtë' pra nisemi nga totali i degës dhe më pas disagregohet në produkte dhe kalimi i këtij sistemi në TIO përjashtohen Modeli A dhe B tabelat produkt-produkt. Modeli C dhe D bazohen në tabelat industri-industri me supozimin se çdo industri ka strukturën e saj të shitjeve pavarësisht nga industria në të cilën prodhohet dhe Modeli D eleminon edhe elementët negativ që në rastin tonë është edhe modeli më i saktë për derivimin e TIO.
Tabela simetrike input-output përftohet duke shumëzuar koeficientët IO me nivelet koresponduese të outputit.

TP = matrica e koeficientëve IO * TB
Pra, matrica e koeficientëve IO llogaritet si
Matrica e koeficientëve IO = $TB*(1- TP)_{-1}$
Pavarësisht metodës të përzgjedhur tabela simetrike input-output nuk do të jetë plotësisht konsistente me tabelën e balancuar të burimeve dhe përdorimeve, si rezultat modeli i mësipërm modifikohet dhe diferencat shpërndahen për krijimin e një tabele të re përdorimesh.

TP = matrica e koeficientëve IO * TB * matricën e diferencave

Më poshtë shikojmë paraqitjen teknike të derivimit të tabelave të burimeve dhe përdorimeve në tabela input-output sipas Modelit D.
Industri për Industri, tabela Input-Output; Struktura e shitjeve konstante sipas produkteve (Modeli D)

Industri për Industri, tabela Input-Output; Struktura e shitjeve konstante sipas produkteve (Modeli D)

- Formula:
- B = D,Z, diag(g)
- F = D,Y
- Koeficientët:
- D,Z

- U: Konsumi ndërmjetëm (produkt x industri)
- V': Outputi (produkt x industri)
- Y: Kërkesa përfundimtare (produkt x transaksion)
- y: Kërkesa përfundimtare totale (numër i vetëm ose 1x1)
- W: Komponentët e Vlerës së Shtuar (VA) (transaksion x industri)
- w: Vlera e shtuar totale (numër i vetëm ose 1x1)
- q: Përdorimi total (produkt x 1)
- qT: Përdorimi total (industri x 1)
- gT: Outputi total (1 x industri)
- g: Outputi total (1 x produkt)
- B: IO kërkesa ndërmjetme (industri x industri)
- F: IO kërkesa finale (industri x transaksion)
- S: IO kërkesa ndërmjetme (produkt x produkt)
- E: IO vlera e shtuar (transaction x produkt)

Transpozojmë matricën; "produktet" vendosen në vendin e rreshtave, "industritë" në kolona, "transaksionet" zenë vend për numrin e kategorive të kërkesës përfundimtare.

Përkufizime:
Z = U, inv(diag(g)) (matrica e koefiçientëve të Inputit të ndërmjetëm të industrisë)
L = W, inv(diag(g)) (matrica koefiçientëve të vlerës shtuar industrisë)
C = V, inv(diag(g)) (matrica e pjesëve të tregut)
D = V, inv(diag(q)) (matrica e pjesëve të tregut)

Komanda, diag() krijon një matricë me elementë jo zero vetëm në diagonale; komanda inv() i kthen elementët e një matrice në elementë të anasjelltë.

Anekse:
Aneksi 1: Shkurtime dhe akronime

ABF - Anketa e Buxhetit të Familjes
ASN - Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve
BEC - Nomenklatura e Zgjeruar Ekonomike
BoP – Bilanci i Pagesave
C - Konsumi Final i Familjeve
CN - Nomenklatura e Kombinuar
COICOP – Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit
CPA - Klasifikimi Statistikor i Produkteve sipas Aktivitetit
CPC – Klasifikimi Qendror i Produkteve
ESA - Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare
FBKF - Formimi Bruto i Kapitalit Fiks
FIFO – Hyrje parë - dalje parë
FISIM - Shërbimet Ndërmjetësuese Financiare të Matura Indirekt
HS - Sistemi i Harmonizuar
IÇK - Indeksi i Çmimit të Konsumit
IÇP - Indeksi i Çmimit të Prodhimit
IKN - Indeksi i Kushtimit në Ndërtim
ISIC - Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Aktiviteteve Ekonomike
KN - Konsumi i Ndërmjetëm
LIFO - Hyrje fundit - dalje parë
MQP - Metoda e Qarkullimit të Produkteve
NACE - Klasifikimi i Aktiviteteve Ekonomike në Evropë
NVE - Nomenklatura e Veprimtarisë Ekonomike
PASH - Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve
PBB - Produkti i Brendshëm Bruto
PRODCOM - Production Communautaire
SITC - Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Tregtisë
SLLK - Sistemi i Llogarive Kombëtare
SNA – Sistemi Ndërkombëtar i Aktiviteteve
TBP - Tabelat e Burimeve dhe Përdorimeve
TIO - Tabelat Input-Output
TVSH - Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UVI - Indeksi i Vlerës Njësi
VSHB - Vlera e Shtuar Bruto

Aneksi 2: Tabelat e burimeve,përdorimeve dhe input-outputeve, 2011

Aneksi 2.1: Tabela e burimeve

	Aktivitete (NVE)	Aktivitetet NVE											
Kodi		Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	Peshkimi	Nxjerrja e mineraleve energjetike	Nxjerrja e mineraleve jo energjetike	Industria e përpunimit të drithërave	Industri të tjera të produkteve ushqimore	Industria e tekstileve dhe lëkurës	Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	Industria kimike dhe e kauçukut	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë	Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve
	Produkte (CPA)	A1	A2	A3	A4	A5	A6	A7	A8	A9	A10	A11	A12
A1	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	238.681	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A2	Peshkimi	0	4.220	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A3	Nxjerrja e mineraleve energjitike	0	0	50.733	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A4	Nxjerrja e mineraleve jo energjitike	0	0	0	35.257	2	0	0	5	0	0	40	81
A5	Industria e përpunimit të drithërave	88.493	1.357	0	0	49.777	0	3	0	0	0	0	0
A6	Industri të tjera të produkteve ushqimore	0	0	0	0	0	915	0	0	0	0	0	0
A7	Industria e tekstileve dhe lëkurës	42	0	0	0	0	0	43.329	0	0	0	0	105
A8	Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	0	0	0	95	0	0	92	49.524	0	344	0	34
A9	Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	0	0	0	0	0	0	0	0	17.291	0	0	0
A10	Industria kimike dhe e kauçukut	0	0	0	0	165	0	59	269	0	15.282	114	0
A11	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë	0	0	0	271	0	0	0	0	0	104	49.506	0
A12	Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	0	0	0	0	0	0	0	9	0	0	0	40.204
A13	Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A14	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A15	Ndërtimi	0	0	128	912	77	0	0	125	0	652	603	0
A16	Tregtia	0	17	0	284	2.553	0	272	4.155	0	456	459	4.863
A17	Hotele dhe restorante	0	209	5	0	16	0	46	10	0	0	0	0
A18	Transporti	0	0	0	45	145	0	0	0	0	175	56	4.593
A19	Posta dhe komunikacioni	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A20	Aktivitete financiare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A21	Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	0	0	0	0	37	0	16	506	0	0	0	14
A22	Administrata publike dhe e mbrojtjes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A23	Arsimi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A24	Shëndeti	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A25	Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	0	0	20	20	0	0	3	206	0	0	0	0
	Totali i prodhimit sipas aktiviteteve	327.216	5.803	50.886	36.884	52.772	915	43.821	54.809	17.291	17.013	50.778	49.894

Aneksi 2.1: Tabela e burimeve (vazh...)

Kodi	Aktivitete (NVE)	Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	Ndërtimi	Tregtia	Hotele dhe restorante	Transporti	Posta dhe komunikacioni	Aktivitete financiare	Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	Administrata publike dhe e mbrojtjes	Arsimi	Shëndeti	Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale
	Produkte (CPA)	A13	A14	A15	A16	A17	A18	A19	A20	A21	A22	A23	A24	A25
A1	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A2	Peshkimi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A3	Nxjerrja e mineraleve energjetike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A4	Nxjerrja e mineraleve jo energjetike	0	0	1.060	53	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A5	Industria e përpunimit të drithërave	0	0	0	585	0	0	0	0	0	0	0	0	12
A6	Industri të tjera të produkteve ushqimore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A7	Industria e tekstileve dhe lëkurës	0	0	0	25	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A8	Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	0	0	78	50	0	0	2.300	0	0	0	0	0	0
A9	Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A10	Industria kimike dhe e kauçukut	0	0	4	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A11	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë	0	0	71.997	36	32	0	0	0	0	0	0	0	0
A12	Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	0	0	0	18	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A13	Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	4.207	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A14	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	0	43.412	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A15	Ndërtimi	0	0	347.534	1.066	44	98	0	0	215	0	0	1.946	9
A16	Tregtia	0	0	6.312	211.600	435	2.215	2	0	5	0	53	1.455	14
A17	Hotele dhe restorante	0	0	538	1.833	46.445	40	0	0	275	0	23	98	39
A18	Transporti	0	0	7.801	4.113	0	121.721	0	0	0	0	84	0	0
A19	Posta dhe komunikacioni	0	0	0	0	0	0	80.020	0	161	0	0	0	0
A20	Aktivitete financiare	0	0	0	0	0	0	0	50.983	0	0	0	0	0
A21	Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	0	0	36.811	292	13	4	3.506	0	166.891	230	887	0	3.632
A22	Administrata publike dhe e mbrojtjes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	74.028	789	302	6.947
A23	Arsimi	0	0	189	1	0	0	0	0	0	0	57.457	2.249	5.566
A24	Shëndeti	0	0	13	4	0	0	0	0	0	0	3.258	41.172	0
A25	Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	0	54	1.398	2	7	0	0	0	2	0	53	193	65.049
	Totali i prodhimit sipas aktiviteteve	4.207	43.466	473.733	219.679	46.976	124.078	85.828	50.983	167.549	74.258	62.604	47.415	81.269

Aneksi 2..1: Tabela e burimeve (vazh...)

Kodi	Aktivitetet NVE	Totali i Prodhimit sipas aktiviteteve	Importet	Totali i burimeve me çmime bazë	Taksat neto mbi produktet	Marzhi i Tregtisë dhe Transportit	Totali i Burimeve me çmime tregu
	Produkte (CPA)						
A1	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	238.681	23.942	262.624	6.875	51.484	320.983
A2	Peshkimi	4.220	492	4.712	130	1.157	5.999
A3	Nxjerrja e mineraleve energjetike	50.733	3.369	54.102	1.643	1.438	57.182
A4	Nxjerrja e mineraleve jo energjetike	36.498	1.446	37.944	695	5.395	44.034
A5	Industria e përpunimit të drithërave	140.228	54.114	194.342	22.309	46.887	263.537
A6	Industri të tjera të produkteve ushqimore	915	8.108	9.023	5.713	2.337	17.073
A7	Industria e tekstileve dhe lëkurës	43.500	57.389	100.889	5.084	25.917	131.890
A8	Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	52.515	29.031	81.546	6.404	21.664	109.614
A9	Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	17.291	65.756	83.046	58.284	12.157	153.487
A10	Industria kimike dhe e kauçukut	15.896	57.565	73.461	12.317	23.849	109.627
A11	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë	121.946	17.498	139.443	6.151	24.713	170.308
A12	Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	40.231	62.260	102.491	10.600	26.529	139.621
A13	Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	4.207	108.685	112.892	22.324	30.734	165.951
A14	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	43.412	21.187	64.599	-3.150	0	61.448
A15	Ndërtimi	353.411	389	353.800	4.967	0	358.766
A16	Tregtia	235.149	14.111	249.260	588	-220.511	29.337
A17	Hotele dhe restorante	49.578	41.341	90.919	- 45	0	90.873
A18	Transporti	138.734	70.541	209.275	21	-54.907	154.388
A19	Posta dhe komunikacioni	80.181	18.836	99.017	1.598	442	101.057
A20	Aktivitete financiare	50.983	15.570	66.553	266	0	66.819
A21	Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	212.839	13.400	226.239	1.320	489	228.048
A22	Administrata publike dhe e mbrojtjes	82.066	1.305	83.371	10	0	83.382
A23	Arsimi	65.462	4.969	70.431	13	0	70.444
A24	Shëndeti	44.446	11.498	55.944	91	0	56.036
A25	Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	67.005	35.292	102.297	5.293	227	107.818
	Totali i prodhimit sipas aktiviteteve	2.190.127	738.093	2.928.221	169.503	0	3.097.724

Aneksi 2.2: Tabela e Përdorimeve

Kodi	Aktivitetet NVE	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	Peshkimi	Nxjerrja e mineraleve energjetike	Nxjerrja e mineraleve jo energjetike	Industria e përpunimit të drithërave	Industri të tjera të produkteve ushqimore	Industria e tekstileve dhe lëkurës	Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	Industria kimike dhe e kauçukut	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë	Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve
	Aktivitetet NVE												
	PRODUKTE (CPA)	A1	A2	A3	A4	A5	A6	A7	A8	A9	A10	A11	A12
A1	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	68.849	7	1	2	19.899	513	1.552	1.556	0	26	78	1
A2	Peshkimi	0	98	0	0	522	0	1	5	0	0	26	0
A3	Nxjerrja e mineraleve energjetike	11	0	348	89	0	0	0	3	13.632	84	2.172	1.511
A4	Nxjerrja e mineraleve jo energjetike	3	0	489	3.901	19	0	27	129	1	227	4.334	519
A5	Industria e përpunimit të drithërave	1.372	1.684	3	168	6.688	0	41	89	1	13	1	0
A6	Industri të tjera të produkteve ushqimore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A7	Industria e tekstileve dhe lëkurës	0	311	8	36	323	6	13.165	934	0	400	59	41
A8	Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	29	55	202	2.176	1.216	20	1.167	20.236	0	582	4.262	3.325
A9	Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	2.334	1.157	505	5.107	747	36	444	706	1.225	344	5.921	3.879
A10	Industria kimike dhe e kauçukut	9.476	12	725	1.034	3.728	24	798	2.259	177	8.212	1.211	3.141
A11	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë	2.468	4	0	1.648	636	5	12	78	25	932	11.986	139
A12	Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	14	7	3.930	3.847	1.756	12	83	4.932	234	535	1.096	19.102
A13	Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	45	6	6.193	2.171	1.102	9	1.634	1.045	44	183	824	1.556
A14	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	1.456	36	275	426	885	13	395	825	282	257	688	645
A15	Ndërtimi	176	5	6	29	57	7	120	184	0	129	2.450	15
A16	Tregtia	320	1	37	25	53	0	79	98	0	13	81	24
A17	Hotele dhe restorante	0	0	6	0	32	0	10	9	0	0	0	0
A18	Transporti	2.021	15	548	987	149	0	1.279	1.803	0	262	787	1.475
A19	Posta dhe komunikacioni	0	62	134	152	124	4	102	285	0	64	537	94
A20	Aktivitete financiare	325	76	887	233	722	12	624	787	218	296	857	657
A21	Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	3.308	210	1.372	744	1.083	19	871	2.166	231	296	777	666
A22	Administrata publike dhe e mbrojtjes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A23	Arsimi	0	7	44	102	42	15	86	53	0	14	24	46
A24	Shëndeti	0	1	8	19	8	3	16	10	0	3	5	9
A25	Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Totali i Konsumit Ndërmjetës sipas aktiviteteve	92.205	3.752	15.723	22.897	39.789	697	22.505	38.192	16.070	12.872	38.177	36.845
	Vlera e Shtuar sipas aktiviteteve	235.011	2.051	35.163	13.987	12.984	219	21.316	16.617	1.221	4.141	12.602	13.049

Aneksi 2.2: Tabela e Përdorimeve (vazh..)

Kodi	Aktivitetet NVE	Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	Ndërtimi	Tregtia	Hotele dhe restorante	Transport	Posta dhe komunikacion	Aktivitete financiare	Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qera dhe shërbime për ndërmarrjet	Administrata publike dhe e mbrojtjes	Arsimi	Shëndeti	Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale
	Aktivitetet NVE							Aktivitetet NVE						
	PRODUKTE (CPA)	A13	A14	A15	A16	A17	A18	A19	A20	A21	A22	A23	A24	A25
A1	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0	0	658	7.866	2.979	8	0	0	298	84	15	9	122
A2	Peshkimi	0	0	115	40	1.783	0	0	0	45	18	56	26	54
A3	Nxjerrja e mineraleve energjetike	0	0	3.210	38	0	13	0	0	0	0	0	0	0
A4	Nxjerrja e mineraleve jo energjetike	7	3	17.686	1.005	0	569	0	0	8	0	0	0	50
A5	Industria e përpunimit të drithërave	0	0	104	7.858	9.330	1	24	0	71	1.556	540	973	2.213
A6	Industri të tjera të produkteve ushqimore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
A7	Industria e tekstileve dhe lëkurës	1	1	2.745	1.850	286	280	26	0	2.540	741	195	146	556
A8	Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	130	106	5.436	5.755	471	924	6.186	215	3.826	2.666	1.674	443	4.693
A9	Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit	9	1.329	33.575	19.055	622	30.503	317	67	5.963	2.260	977	1.038	2.410
A10	Industria kimike dhe e kauçukut	135	237	6.356	2.703	317	1.421	397	106	650	698	778	7.105	1.710
A11	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë	16	80	132.101	4.958	498	159	51	0	116	0	0	0	42
A12	Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	336	1.065	38.036	1.587	34	63	657	30	863	80	519	147	915
A13	Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	1.100	78	11.720	7.016	136	10.983	4.655	93	3.409	1.193	1.167	514	1.695
A14	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	40	111	2.827	1.428	699	1.494	993	343	1.436	962	770	980	1.498
A15	Ndërtimi	4	1.279	28.878	270	484	2.784	3	0	6.019	470	468	613	422
A16	Tregtia	6	37	152	197	5	391	16	47	14	129	11	59	5
A17	Hotele dhe restorante	0	13	142	35	19	1.400	0	142	469	1.037	491	457	2.708
A18	Transporti	87	984	4.201	2.341	222	14.788	1.682	69	2.793	895	583	204	1.735
A19	Posta dhe komunikacioni	44	4.596	3.237	880	732	1.763	14.141	2.552	2.996	892	433	157	1.762
A20	Aktivitete financiare	87	2.050	6.358	9.048	1.256	3.581	530	4.804	1.369	917	1.023	1.029	2.973
A21	Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	161	3.433	8.199	5.225	2.220	6.458	22.211	8.638	15.836	847	900	413	10.362
A22	Administrata publike dhe e mbrojtjes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4.972	1.068	282	1.097
A23	Arsimi	94	45	1.114	143	113	396	585	362	1.987	656	88	21	937
A24	Shëndeti	18	9	210	27	21	75	110	0	375	171	24	8	318
A25	Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	0	0	3.669	0	0	0	0	39	20	1.770	169	1.008	1.150
	Totali i Konsumit Ndërmjetës sipas aktiviteteve	2.277	15.455	310.729	79.326	22.227	78.055	52.583	17.506	51.103	23.013	11.949	15.634	39.428
	Vlera e Shtuar sipas aktiviteteve	1.931	28.011	163.004	140.354	24.749	46.023	33.245	33.477	116.446	51.245	50.655	31.781	41.841

Aneksi 2.2: Tabela e Përdorimeve (vazh..)

Kodi	Aktivitetet NVE	Totali i konsumit ndërmjetës sipas produkteve	Eksportet FOB	Konsumi final i familjeve	Konsumi final i qeverisë dhe OJF - ve	Formimi i kapitalit fiks bruto	Ndryshim gjendje	Totali i përdorimeve me çmime tregu
	PRODUKTE (CPA)							
A1	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	104.521	3.777	202.787	493	9.406	0	320.983
A2	Peshkimi	2.790	244	2.949	17	0	0	5.999
A3	Nxjerrja e mineraleve energjetike	21.111	31.785	0	0	0	4.287	57.182
A4	Nxjerrja e mineraleve jo energjetike	28.976	11.833	1.131	0	0	2.093	44.034
A5	Industria e përpunimit të drithërave	32.727	8.938	215.671	0	0	6.201	263.537
A6	Industri të tjera të produkteve ushqimore	0	38	16.843	0	0	192	17.073
A7	Industria e tekstileve dhe lëkurës	24.650	65.951	37.803	0	0	3.486	131.890
A8	Industria e drurit, letrës, mobiljeve dhe publikimit	65.795	6.949	30.880	427	2.126	3.436	109.614
A9	Industria e rafinimit të naftës, koksifikimit		3.283	27.679	0	0	1.995	153.487
A10	Industria kimike dhe e kauçukut	53.411	2.863	50.576	0	1	2.776	109.627
A11	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jo metalikë		6.571	2.860	0	0	4.924	170.308
A12	Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve	79.878	40.254	7.318	0	5.231	6.939	139.621
A13	Fabrikimi i makinerive dhe pajisjeve	58.568	7.998	30.609	0	66.203	2.573	165.951
A14	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike dhe gazit	19.763	6.690	34.208	788	0	0	61.448
A15	Ndërtimi	44.873	8.519	518	13	304.843	0	358.766
A16	Tregtia	1.800	13.591	13.946	0	0	0	29.337
A17	Hotele dhe restorante	6.973	44.313	39.588	0	0	0	90.873
A18	Transporti	39.911	62.234	51.691	552	0	0	154.388
A19	Posta dhe komunikacioni	35.743	32.735	32.579	0	0	0	101.057
A20	Aktivitete financiare	40.720	7.809	18.291	0	0	0	66.819
A21	Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënies me qira dhe shërbime për ndërmarrjet	96.645	27.336	100.847	437	2.782	0	228.048
A22	Administrata publike dhe e mbrojtjes	7.421	3.900	2.749	69.313	0	0	83.382
A23	Arsimi	6.972	1.892	19.578	42.002	0	0	70.444
A24	Shëndeti	1.448	3.983	21.801	28.804	0	0	56.036
A25	Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	7.827	38.906	59.062	2.023	0	0	107.818
	Totali i Konsumit Ndërmjetës sipas aktiviteteve	1,059,007	442.390	1.021.965	144.869	390.592	38.902	3.097.724
	Vlera e Shtuar sipas aktiviteteve	1,131,121						

Bibliografia

"Eurostat Manual of Supply, Use and Input Output Tables" [Report] / autor Eurostat. - Luxembourg : [s.n.], 2008.
"Handbook on price and volume measures in national accounts" [Book] / autor Eurostat. - Luxembourg : Eureopean Communities, 2001.
"Input-OUTPUT FRAMEWORK" [Book Section] / autor Eurostat // European System of Account 1995 (ESA95). - Luxembourg : Official Publications of the European Communities, 1995.
"Supply and use tables and the input-output framework" [Book Section] / autor Eurostat // European System of Accounts 2010 (ESA2010). - Luxenbourg : [s.n.], 2010.
"The Impact of Trade Margins Matrix on the Statistical Sources"/ autor Roberta PIERGIOVANNI, Stefano PISANI. (1998).
"A Use-Side Procedure for Estimating Trade Margin in Input-Output Analysis"/ autor J.Rueda-Cantuche, A. Morena, M.Pardo "
"Exploratory Data Analysis Addison"-Wesley, 1977 autor John W. Tukey.